


STATUS RAPORT 2020

FINANCAT PUBLIKE VENDORE



FINANCAT PUBLIKE VENDORE STATUS RAPORT 2020

© Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

"Ky publikim është produkt i Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në kuadër të projektit "Financat Vendore dhe Perceptimi i Qytetarëve mbi Shërbimet Vendore" me mbështetjen financiare të LevizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC. Opinionet dhe konkluzionet e këtij publikimi i përkasin autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht këndvështrimet e Qeverisë Zvicerane apo të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC."

FINANCAT
PUBLIKE
VENDORE

Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Tabela e përmbajtjes

Lista e Grafikëve.....	6
Lista e Tabelave.....	9
Lista e Hapesirave Informuese.....	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	11
1. BURIMET E FINANCMIT TË BASHKIVE.....	13
1.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore.....	23
1.1.1 Të ardhurat nga taksat vendore.....	32
1.1.2 Të ardhurat nga tarifat vendore.....	50
1.1.3 Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura.....	54
1.2 Të ardhurat nga taksat e ndara.....	63
1.3 Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale.....	64
1.4 Transfertat e kushtëzuara.....	71
1.5 Burimet financiare: sa dhe nga buruan paratë në dispozicion të bashkive në vitin 2020?.....	73
2. SI I PËRDORËN BASHKITË PARATË NË DISPOZICION?.....	78
2.1 Shpenzimet sipas burimit të financimit.....	84
2.2 Shpenzimet e kryera me fonde të veta të bashkive.....	87
2.2.1 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit ekonomik.....	89
2.2.2 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional.....	102
2.3 Shpenzimet e kryera me fonde nga transferta të kushtëzuara.....	108
2.3.1 Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas klasifikimit ekonomik.....	109
2.3.2 Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas klasifikimit funksional.....	113
2.4 Sa shpenzuan bashkitë në vitin 2020?.....	114
3. PËRFUNDIME.....	124
Aneksë.....	129
Referenca.....	152

Lista e Grafikëve

Grafik 1. Tregues të të ardhurave ndaj PBB-së.....	14
Grafik 2. Tregues të të ardhurave ndaj të ardhurave të qeverisë së përgjithshme.....	15
Grafik 3. Autonomia financiare (treguesi A).....	19
Grafik 4. Autonomia financiare (treguesi B).....	20
Grafik 5. Autonomia financiare (treguesi C).....	21
Grafik 6. Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore.....	22
Grafik 7. Të ardhura nga burimet e veta vendore sipas bashkive (ndryshime vjetore në %)......	25
Grafik 8. Të ardhura nga burimet e veta vendore 11 bashkitë e prekura nga tërmeti.....	26
Grafik 9. Kontributi sipas kategorive (në p.p.) në ndryshimin vjetor të të ardhurave nga burimet e veta vendore (në %).....	27
Grafik 10. Struktura e të ardhurave sipas përmasës së bashkisë.....	28
Grafik 11. Struktura e të ardhurave nga burimet e veta vendore në 61 bashki.....	30
Grafik 12. Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas bashkive, viti 2020.....	31
Grafik 13. Ecuria e të ardhurave nga taksat vendore.....	32
Grafik 14. Të ardhurat nga taksat vendore sipas zërave kryesorë.....	33
Grafik 15. Të ardhurat nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme.....	34
Grafik 16. Të ardhura nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme sipas bashkive.....	35
Grafik 17. Pësia e bashkive në të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme.....	36
Grafik 18. Të ardhura nga taksat mbi ndërtesën dhe tokën bujqësore, viti 2020.....	37
Grafik 19. Ecuria e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.....	38
Grafik 20. Tregues të zhvillimeve në sektorin e ndërtim.....	39
Grafik 21. Rëndësia e të ardhurave nga TNI në buxhetet vendore.....	41
Grafik 22. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total=100%).....	42
Grafik 23. Ecuria e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.....	43
Grafik 24. Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier.....	44
Grafik 25. Turizmi dhe të ardhurat nga taksa e hotelit (ndryshime vjetore).....	45
Grafik 26. Ecuria e të ardhurave nga tarifat vendore.....	51
Grafik 27. Ecuria e të ardhurave nga tarifat vendore sipas bashkive, viti 2020.....	52
Grafik 28. Ecuria e të ardhurave nga tarifat vendore.....	53
Grafik 29. Borxhi publik përkundrejt kriterit të Mastriktit.....	56
Grafik 30. Stoku i detyrimeve të prapambetura ndërvite.....	57
Grafik 31. Pësia e bashkive në stokun e detyrimeve të prapambetura.....	58
Grafik 32. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas kategorive.....	58
Grafik 33. Detyrimet e prapambetura për frymë (në mijë lekë).....	59
Grafik 34. Vlerësim i paaftësisë paguese të bashkive.....	62

Grafik 35. Ecuria e të ardhurave nga taksat e ndara.....	63
Grafik 36. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar ndërvite.....	65
Grafik 37. Rëndësia e transfertës së pakushtëzuar në burimet e financimit të bashkive.....	66
Grafik 38. Parashikimi i nivelit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme.....	67
Grafik 39. Transferta e pakushtëzuar sektoriale.....	68
Grafik 40. Transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas funksioneve (1).....	69
Grafik 41. Transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas funksioneve (2).....	70
Grafik 42. Transfertat e kushtëzuara sipas funksioneve.....	72
Grafik 43. Ecuria e burimeve financiare totale.....	73
Grafik 44. Kontributi i kategorive (në pikë përqindje) në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në përqindje).....	75
Grafik 45. Tregues të shpenzimeve ndaj PBB-së.....	79
Grafik 46. Tregues të shpenzimeve ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme.....	64
Grafik 47. Tregues të investimeve ndaj PBB-së.....	81
Grafik 48. Tregues të investimeve ndaj investimeve publike.....	82
Grafik 49. Shpenzimet vendore dhe qendrore sipas funksioneve.....	83
Grafik 50. Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit.....	85
Grafik 51. Mbulimi i shpenzimeve sipas burimit.....	85
Grafik 52. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional dhe burimit të financimit.....	86
Grafik 53. Ecuria e shpenzimeve me fonde të veta të bashkive.....	87
Grafik 54. Shpenzimet me fondet të veta sipas bashkive.....	88
Grafik 55. Struktura e shpenzimeve me fonde të veta.....	90
Grafik 56. Shpenzimet me fonde të veta sipas natyrës ekonomike.....	90
Grafik 57. Shpenzimet operative sipas zërave.....	91
Grafik 58. Transfertat sipas bashkive (diferenca me vitin 2019).....	93
Grafik 59. Prirja e shpenzimeve kapitale me fonde të veta.....	94
Grafik 60. Financimi i shpenzimeve kapitale nga TNI.....	95
Grafik 61. Financimi i shpenzimeve kapitale nga TNI sipas bashkive.....	96
Grafik 62. Shpërndarja e investimeve sipas funksioneve.....	97
Grafik 63. Struktura e shpenzimeve me fonde të veta sipas kategorive dhe përmasës së bashkive.....	98
Grafik 64. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e mëdha.....	99
Grafik 65. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e mesme.....	100
Grafik 66. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e vogla.....	101
Grafik 67. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e vogla.....	102
Grafik 68. Shpenzimet me fonde të veta sipas funksioneve.....	103
Grafik 69. Indeksi i shpenzimeve me fonde të veta (bashkitë përkundrejt mesatares).....	107
Grafik 70. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara.....	108

Grafik 71. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas natyrës ekonomike.....	109
Grafik 72. Shpenzimet korrente me fonde të kushtëzuara.....	110
Grafik 73. Shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara.....	111
Grafik 74. Shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara sipas bashkive (viti 2020).....	112
Grafik 75. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas funksioneve të qeverisjes.....	113
Grafik 76. Përdorimi i burimeve financiare totale.....	114
Grafik 77. Shpenzime kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale.....	115
Grafik 78. Shpenzimeve kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale.....	117
Grafik 79. Kosto mesatare mujore për të punësuar në bashki.....	119
Grafik 80. Numri i të punësuarve (në total dhe sipas bashkive).....	120
Grafik 81. Të punësuar në bashki për 1,000 banorë.....	121

Lista e Tabelave

Tabelë 1. Autonomia financiare (viti 2020).....	17
Tabelë 2. Taksat vendore në Shqipëri.....	47
Tabelë 3. Fuqia taksuese e bashkive.....	48
Tabelë 4. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive.....	54
Tabelë 5. Të dhëna mbi huamarrjen vendore.....	56
Tabelë 6. Burime financiare sipas kategorive.....	74

Lista e Hapësirave Informuese

Hapësirë informuese 1.	
Autonomia financiare: sa të pavarura janë bashkitë?.....	16
Hapësirë informuese 2.	
Fuqia taksuese e bashkive.....	46
Hapësirë informuese 3.	
Si shpenzuan 61 bashkitë në vitin 2020?.....	97
Hapësirë informuese 4.	
Shpenzimet me fonde të veta: si paraqiten bashkitë?.....	106
Hapësirë informuese 5.	
Shpenzimet e personelit dhe numri i të punësuarve në 61 bashki.....	118

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i Financave Publike Vendore 2020 paraqet një panoramë të detajuar të menaxhimit financiar publik në nivel vendor, nën presionin e situatave të fatkeqësive natyrore të tërmeteve të fund vitit 2019 dhe pandemisë së COVID-19 që përfshiu botën që prej fillim vitit 2020. Mbivendosja e pasojave të tërmeteve me situatën e pandemisë të COVID-19, përballi qeveritë në të gjitha nivelet me vështirësi, sfida dhe të panjohura të mëdha. Në përgjigje të situatës, fillimisht qeveria qendrore ndërmori një sërë masash që synonin frenimin e përhapjes së pandemisë në popullatë, duke zbatuar një sërë masash shtrënguese të cilat sollën tkurrjen e PBB-së nominale me rreth 6.4%.¹ Krahas tyre, një seri masash mbështetëse për familjet dhe bizneset u ndërmorën nga qeveria qendrore dhe bashkitë në vend.²

Në vitin 2020, bashkitë u gjendën të papërgatitura për një emergjencë të këtij lloji dhe përmase, çka preku ndjeshëm financat e tyre. Në kahun e të ardhurave, 61 bashkitë në vend vlerësohet të kenë patuar më shumë mjete financiare në dispozicion për të ushtruar funksionet dhe kompetencat për të cilat ato janë përgjegjëse. Megjithatë, përballimi në terma financiarë i efekteve të pandemisë duket të jetë mbuluar me fonde të cilat u transferuan nga qeveria qendrore në trajtën e transfertave ndërqeveritare (transferta të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara). Në të kundërt, të ardhurat e mbledhura nga burimet e veta vendore vlerësohet të jenë ndikuar negativisht në vijim të fatkeqësive natyrore duke shënuar rënie vjetore. Ndër faktorët që mund të kenë çuar në rënien e të ardhurave nga burimet e veta vendore mund të renditen: përkeqësimi i gjendjes financiare të bizneseve dhe të familjeve që mund të ketë përcaktuar mos pagesa, futja e masave fiskale lehtësuese për kategoritë në nevojë, zhvendosja në kohë e pagesave për detyrimet vendore etj. Nevojat për shpenzime gjatë vitit 2020 u intensifikuan ndjeshëm në tre drejtime: përshtatja në mënyrën e ofrimit të shërbimeve nën kushtet e kufizimeve të vendosura prej COVID-19, mbështetjes së menjëhershme të shtresave në nevojë me produkte dhe shërbime bazike, përshtatja e burimeve njerëzore në varësinë e bashkisë me një mënyrë të re të punuari. Për pasojë, shpenzimet korrente vijuan të rriten në terma vjetorë dhe gërhëra u vendos tek investimet.

Në seksionin e dytë të këtij raporti, do të paraqitet një analizë e detajuar e burimeve të financimit të 61 bashkive në vend, në total dhe sipas bashkive. Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion analizohet gjerësisht në seksionin e tretë. Analiza e financave vendore për vitin 2020 mbyllet me një sërë përfundimesh që gjenden në seksionin e katërt.

1 BURIMET E FINANCIMIT TË BASHKIVE

Bashkitë, përfaqësojnë nivelin e qeverisjes më pranë qytetarëve dhe si të tilla, potencialisht janë në gjendje të adresojnë më mirë se qeveria qendrore nevojat e komuniteteve që ato përfaqësojnë. Bazuar në përparësitë informative që bashkitë gëzojnë përkundëjt qeverisjes qendrore, oferta për të mira dhe shërbime publike mund të përshtatet potencialisht më mirë me nevojat - preferencat e qytetarëve. Përgjatë periudhës 2015 - 2018, qeverisja vendore kaloi një proces reformimi shumëpërmasor, nën termin decentralizim, duke synuar gjerësisht fuqizimin e qeverisjes vendore nëpërmjet krijimit të kushteve dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me cilësi dhe eficiencë.³ Për këtë qëllim, bashkitë mbledhin të ardhura drejtpërdrejt nga taksapaguesit (familjarë, biznese dhe institucione) dhe përftojnë burime financiare nga nivele të tjera të qeverisjes (si qeveria qendrore), për të mbuluar nevojat për shpenzime për ofrimin e shërbimeve publike vendore. Analiza dhe monitorimi në kohë i menaxhimit të financave vendore (nga burojnë paratë dhe si shpenzohen ato nga 61 bashkitë në vend) përfaqëson një hap tjetër të rëndësishëm në funksion të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së bashkive në përdorimin e parave publike që ato kanë në dispozicion.

Viti 2020 ishte një vit i pazakontë, ku dëmeve të mëdha të lëna pas nga tërmetet e fundvitit 2019 (tërmeti i 21 Shtatorit dhe 26 Nëntorit 2019) iu mbivendosën efektet e menjëhershme të krizës shëndetësore të shkaktuara nga COVID-19. Përballja me këto vështirësi, në një anë nënvizoi sërish rëndësinë e bashkive në jetën e komuniteteve që ato përfaqësojnë, në anën tjetër nxori në pah dobësitë strukturore të tyre: 61 bashkitë në Shqipëri janë shumë të ndryshme ndërmjet tyre, nuk kanë autonomi financiare apo janë të varura financiarisht nga transfertat ndërqeveritare, nuk kanë një mekanizëm financiar funksional për përballimin situatave të emergjencave dhe aftësitë ripërtëritëse pas tyre vlerësohen të ulëta.⁴

Në terma sasiorë, rëndësia e qeverisjes vendore vlerësohet të jetë rritur bazuar në ecurinë e treguesit të burimeve financiare të bashkive (totale, të disponueshme dhe nga burimet e veta vendore) ndaj PBB-së nominale në pesë vitet e fundit. Priorja rritëse e vërejtur në këta tregues (paraqitur në grafikun 1), vlerësohet të jetë përcaktuar gjerësisht nga ndërhyrjet në legjislacionin që rregullon funksionet (si transferimi i funksioneve të reja në vitin 2016) dhe financat e qeverisjes vendore,⁵ përdorimi i agjentëve tatimorë si ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizime (UK-

të) për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore,⁵ ndryshime të politikës fiskale të bashkive (rritja e taksave dhe tarifave vendore në disa bashki) dhe së fundmi transferimi i fondeve shtesë për përballimin e pasojave të pandemisë së COVID-19 nga qeveria qendrore.


Treguesi i të ardhurave nga burime të veta vendore ndaj PBB-së nominale rezultoi të jetë rritur me 0.6 pikë përqindjeje nga 0.9% në vitin 2015 në rreth 1.5% në fund të vitit 2019 dhe niveli i tij mbeti i pandryshuar në vitin 2020. Rritja ndër vite e shënuar në këtë tregues vlerësohet të jetë ndikuar nga dy elementë kryesorë: rritja e nivelit të taksave vendore (veçanërisht taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (TNI) dhe taksa e ndërtesës)⁶, rritja e nivelit të tarifave vendore dhe përmirësimi në mbledhjen e tyre veçanërisht në zonat urbane

(duke përdorur si agjentë tatimorë ndërmarrjet e UK-ve).

Gjithashtu, theksojmë se ky përmirësim nuk është i shtrirë në të gjitha bashkitë në vend, përkundrazi udhëhiqet nga ecuria e të ardhurave të regjistruara në bashkinë Tiranë dhe konkretisht, nga të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Treguesi i të ardhurave të disponueshme ndaj PBB-së nominale gjithashtu rezultoi të jetë përmirësuar nga viti në vit duke shënuar një nivel prej rreth 3.3% në fund të vitit 2020 nga rreth 1.8% që vlerësohej në vitin 2015. Zhvillimet në kahun përmirësues në këtë tregues vlerësohet të jenë përcaktuar gjerësisht nga stabilizimi dhe rritja e nivelit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale.

Grafik 1. Tregues të të ardhurave ndaj PBB-së




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Intensifikimi i shpenzimeve nën presionin e pandemisë së COVID - 19, vlerësohet të ketë përcaktuar rritjen e treguesit të burimeve financiare totale ndaj PBB-së nominale nga rreth 4.8% në fund të vitit 2019 në rreth 5.8% në vitin 2020. Kjo rritje i detyrohet rritjes së nivelit të transfertave të kushtëzuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për ndihmën ekonomike përgjatë periudhës së pandemisë.⁷

Rëndësia e qeverisjes vendore në qeverisjen e përgjithshme është rritur disi, matur nga treguesit e të ardhurave nga burimet e veta dhe ai nga burimet e disponueshme ndaj të ardhurave totale të qeverisë së përgjithshme (paraqitur në grafikun 2). Në tre vitet e fundit, pesha e qeverisjes vendore në qeverinë e përgjithshme ka përparuar

me ritme të moderuara. Në vitin 2020, ky tregues shënoi një nivel prej rreth 5.7%, në rritje të lehtë me rreth 0.1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Prirje e ngjashme vërehet në ecurinë e treguesit të të ardhurave të disponueshme ndaj të ardhurave të qeverisë së përgjithshme, ndonëse ritmi i rritjes ka qenë më i përshpejtuar ndikuar nga ndërhyrjet në legjislacionin vendor (transferimi i funksioneve të reja, ligji për financat vendore i cili rriti madhësinë e transfertës së pakushtëzuar etj.). Megjithatë, hapësira për përmirësim mbetet e madhe krahasuar me vlerat e të njëjtëve tregues në vendet e Ballkanit Perëndimor (prej rreth 16.3%), vendet e Evropës Jug-Lindore (rreth 17.3%), vendet e BE-së (rreth 23.5%) dhe vendet e OECD-së (me rreth 42.4%).⁸

Grafik 2. Tregues të të ardhurave ndaj të ardhurave të qeverisë së përgjithshme



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Në një vështrim të përgjithshëm, vala e reformave decentralizuese duket të ketë funksionuar në pamje të parë nisur nga niveli dhe prirja e ndjekur nga treguesit e konsideruar (në grafikun 1 dhe grafikun 2). Megjithatë, në një vështrim përtej numrave, decentralizimi duket të ketë funksionuar në terma nominalë

Hapësirë informuese 1

Autonomia financiare: sa të pavarura janë bashkitë?

Autonomia financiare është një koncept i cili në literaturë gjen përkufizime të shumta. Karta Evropiane e Qeverisjes Vendore (1985) në nenin 9, paragrafi 2 përcakton *“nevojën e ekzistencës së një marrëdhënie të përshtatshme ndërmjet burimeve financiare të disponueshme për një organ lokal dhe detyrave që kryen ai. Kjo marrëdhënie është veçanërisht e fortë për funksione të cilat i janë caktuar specifikisht organit vendor.”* Bazuar në këtë përcaktim, një nivel i kënaqshëm i autonomisë financiare/fiskale nënkupton një marrëdhënie të përshtatshme midis burimeve financiare dhe detyrave/funksioneve/kompetencave të qeverisjes vendore. Për të vlerësuar autonominë financiare të bashkive në vend mund të përdoren tregues të ndërtuar mbi të ardhurat dhe shpenzimet. Në këtë hapësirë informuese do të përdorim tre tregues të autonomisë të ndërtuar mbi të ardhurat duke marrë në konsideratë strukturën e burimeve të financimit të bashkive në Shqipëri dhe autoritetin e tyre vendimmarrës mbi këto burime.

Treguesi A, ndërtohet si raport i të ardhurave nga burimet e veta vendore (taksa, tarifa dhe të tjera) ndaj totalit të burimeve financiare vjetore i cili quhet

(përmirësim i treguesve agregatë) por jo në terma realë. Kjo e fundit pasi, bashkitë në vend u përballën me një test me kosto të madhe i cili edhe një herë nënvizoi dhe nxorri në pah dobësitë e tyre strukturore, varësinë nga qeveria qendrore dhe ngurtësinë në menaxhimin financiar.

koncepti i ngushtë i autonomisë financiare të bashkive. Vlera e lartë e këtij treguesi sinjalizon për autonomi financiare të lartë të bashkive (këto të ardhura mund të përdoren në autonomi të plotë, por për rastin e taksave situata është më e komplikuar pasi niveli dhe baza e taksueshme vendoset nga qeveria qendrore).

Treguesi B, ndërtohet si raport i të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe taksave të ndara ndaj totalit të burimeve financiare vjetore. Vlera e lartë e këtij treguesi sinjalizon për autonomi financiare të lartë të bashkive, ndonëse bashkitë nuk kanë autonomi në përcaktimin e nivelit të tyre (por kanë autonomi në përdorim).

Treguesi C, ndërtohet si raport i të ardhurave nga burimet e veta vendore, taksave të ndara dhe transfertave të pakushtëzuara (të përgjithshme dhe specifike) ndaj totalit të burimeve financiare vjetore, koncepti i gjerë i autonomisë financiare të bashkive. Transfertat e pakushtëzuara përdoren në autonomi nga bashkitë (kjo nuk vlen për transfertën sektoriale e cila sillet si transfertë me destinacion të përcaktuar).

Në tabelën 1 paraqiten treguesit e autonomisë financiare (mesatare për 61 bashkitë në vend) për vitin 2015 (si viti në të cilin nis vala e dytë e reformave decentralizuese) dhe periudhën 2018-2020. Pavarësisht konceptit për

autonominë financiare të konsideruar, mesatarisht niveli i autonomisë financiare vlerësohet të jetë i ulët në fund të vitit 2020 dhe i pamjaftueshëm për të siguruar autonominë financiare të bashkive në vend.

Tabelë 1. Autonomia financiare (harku kohor 2015- 2020)

	(A)	(B)	(C)
2020			
Minimumi	2.4%	3.7%	28.4%
Maksimumi	62.3%	64.8%	80.8%
Mesatare	26.6%	29.1%	57.2%
2019			
Minimumi	2.3%	3.1%	34.6%
Maksimumi	65.0%	67.1%	86.0%
Mesatare	31.4%	33.4%	63.7%
2018			
Minimumi	1.8%	2.4%	30.0%
Maksimumi	60.6%	62.5%	79.8%
Mesatare	29.1%	30.9%	59.3%
2015			
Minimumi	2.9%	2.4%	30.0%
Maksimumi	52.0%	62.5%	79.8%
Mesatare	25.2%	30.9%	59.3%

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Treguesi A (koncepti i ngushtë i autonomisë financiare në kahun e të ardhurave), në fund të vitit 2020 shënoi një nivel mesatar prej rreth 26.6% në vitin 2020, në rënie të ndjeshme krahasuar me nivelin e tij rreth 31.4% në vitin 2019. Niveli minimal i Treguesit A ishte rreth 2.4%, nivel ky më i ulët se ai i shënuar në vitin 2015 prej rreth 2.9%. Në të kundërt, niveli maksimal i treguesit A ishte 62.3% në vitin 2020, nivel më i ulët krahasuar me vitin 2019 dhe më i lartë krahasuar me vitin 2015. Thënë ndryshe, ecuria ndër vite e treguesit të autonomisë në konceptin e

ngushtë (pra duke konsideruar peshën që kanë të ardhurat nga burimet e veta vendore ndaj totalit të burimeve), tregon se hapat e ndërmarrë gjatë këtij 5-vjeçari për të fuqizuar financiarisht bashkitë të mos kenë prodhuar rezultatet e synuara nga politikëbërja. Gjithashtu, rritja e taksave dhe tarifave vendore (veçanërisht taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa e ndërtesës dhe tarifat e shërbimeve) duket të mos jetë materializuar në një rritje thelbësore të të ardhurave të tyre dhe për pasojë autonomisë financiare të bashkive (matur nga treguesi A).


Në nivel bashkie për vitin 2020, treguesi A shënon vlerën më të lartë në bashkinë Tiranë me rreth 62.3% ndjekur nga bashkitë Himarë (rreth 52.3%), Sarandë (rreth 40.9%) dhe Vorë (rreth 31.2%). Këto katër bashki janë të vetmet që shënojnë një nivel të treguesit të autonomisë financiare mbi nivelin mesatar kombëtar. Në kahun e kundërt, niveli më i ulët i treguesit A u shënuar në bashkitë Kurbin me rreth 2.4%, ndjekur nga bashkitë Has (rreth 2.6%) dhe Këlcyrë (rreth 2.7%). Rreth 93% e bashkive (57/61) shënojnë një nivel të treguesit A të autonomisë vendore nën mesataren kombëtare, pavarësisht përmasës së tyre në terma të popullsisë dhe numrit të bizneseve në territor (shiko grafikun 3).

Nëse në llogaritjen e treguesit të autonomisë financiare do të përfshinin edhe të ardhurat e përftuara nga taksat e ndara, do të përftonim treguesin B të autonomisë financiare. Në vitin 2020, treguesi B shënoi një vlerë mesatare prej rreth 29.1%, në rënie me rreth 4.3 pikë përqindje krahasuar me nivelin e shënuar nga ky tregues një vit më parë dhe në rënie me rreth 1.8 pikë përqindje krahasuar me nivelin e shënuar në vitin 2015. Në nivel bashkie, treguesi B shënon vlerën më të lartë për vitin 2020 në Bashkinë Tiranë me rreth 64.8% ndjekur nga bashkitë Himarë (rreth 53%), Sarandë (rreth 43.9%) dhe Vorë (rreth 32.3%). Në këto bashki treguesi i autonomisë (treguesi B) qëndron mbi nivelin mesatar prej rreth 29.1%. Në kahun e kundërt, niveli më i


ulët i treguesit B u shënuar në bashkitë Këlcyrë me rreth 3.7% ndjekur nga bashkitë Has (rreth 4.3%) dhe Fushë - Arrëz (rreth 5.1%). Rreth 93% e bashkive (57/61) shënojnë një nivel të treguesit B të autonomisë financiare nën mesataren kombëtare (shiko grafikun 4).

Treguesi (C) apo treguesi i gjerë i autonomisë financiare (i cili përjashton nga llogaritja vetëm transfertat e kushtëzuara), shënoi mesatarisht një nivel prej rreth 57.2% në vitin 2020, në rënie me rreth 6.5 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019 dhe rreth 2.1 pikë përqindje nën nivelin e shënuar në vitin 2015. Niveli minimal i këtij treguesi ishte rreth 28.4% në fund të vitit 2020, nivel ky më i ulët se ai i shënuar në vitin 2019 (prej rreth 34.6%) dhe më i ulët se ai i shënuar në vitin 2015 (prej rreth 30%). Në nivel bashkie, treguesi C shënon vlerën më të lartë për vitin 2020 në bashkitë Tiranë dhe Himarë me rreth 80.8% respektivisht, ndjekur nga bashkitë Sarandë (rreth 67.4%), Konispol (rreth 66.2%), Korçë (rreth 65.5%), Delvinë (rreth 65.4%), Gjirokastër (rreth 65.2%) etj. Në vitin 2020 rreth 17% apo 17/61 bashki shënojnë një nivel të treguesit C të autonomisë financiare mbi mesataren kombëtare (prej rreth 57.2%). Në kahun e kundërt, niveli më i ulët i treguesit C u shënuar në bashkitë Kurbin me rreth 28.4% dhe bashkia Belsh me rreth 28.9%. Rreth 72.1% e bashkive (44/61) shënojnë një nivel të treguesit C të autonomisë vendore nën mesataren kombëtare (shiko grafikun 5).

Grafik 3. Autonomia financiare (treguesi A)




Grafik 4. Autonomia financiare (treguesi B)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 5. Autonomia financiare (treguesi C)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Për të tre treguesit e konsideruar, gjerësia e variacionit mbetet e lartë (diferenca midis nivelit maksimal dhe minimal të treguesit) dhe në rritje në kohë duke shënuar nivele nga 1 deri mbi 2 herë më të lartë se mesatarja për treguesit A dhe B. Në rastin e treguesit C - koncepti i gjerë i autonomisë financiare, gjerësia e variacionit është relativisht më e ulët por në rritje në periudhën në analizë. Kjo do të thotë që në terma të autonomisë financiare bashkitë në vend paraqiten shumë të ndryshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet tyre. Rritja e nivelit të transfertave ndërqeveritare të pakushtëzuara (e përgjithshme dhe specifike), deri diku ka zbutur disi treguesit e gjerësisë së variacionit në treguesit B dhe C, duke zbutur disi ndikimin në burimet financiare të bashkive të goditjeve (tërmetet dhe pandemia e COVID – 19).

Ndonëse nga viti 2015 burimet financiare totale të bashkive kanë ndjekur një prirje rritëse, ecuria e treguesve të autonomisë financiare sugjeron për vijimësi të varësisë së lartë nga qeverisja qendrore apo nivel të ulët të autonomisë vendore. Bazuar në standardet ndërkombëtare (të përdorura në Evropën Perëndimore dhe SHBA) bashkitë gëzojnë autonomi fiskale në rastin kur treguesi C apo ai i konceptit të gjerë të autonomisë vendore qëndron mbi nivelin 80% (Farvacque-Vitkovic & Kopanyi, 2014). Për të gjithë treguesit e konsideruar, bashkitë Tiranë dhe Himarë shënojnë nivelet më të larta të autonomisë vlera që qëndrojnë ndjeshëm mbi mesataren kombëtare. Në rastin e treguesit C, këto dy bashki regjistrojnë një nivel të treguesit të autonomisë financiare i cili qëndron lehtësisht mbi nivelin

e 80%, pra mund të konsiderohen bashki që gëzojnë autonomi financiare. Në të kundërt, mbi 70% e bashkive vlerësohet të paraqesin varësi të lartë financiare apo autonomi të ulët në periudhën e konsideruar, pavarësisht përmasës së tyre në terma të numrit të popullsisë. Tërmetet e fund vitit 2019 së bashku me ato të pandemisë së COVID – 19, ndikuan negativisht në ecurinë e treguesve të autonomisë vendore, të cilët shënuan rënie të theksuar në fund të vitit 2020.

Këto zhvillime sinjalizojnë për ekspozim të lartë të bashkive në terma financiarë ndaj goditjeve të brendshme dhe/ose të jashtme, të cilat materializohen shumë shpejt në financat e bashkive. Krahas varësisë, shqetësuese mbetet diferenca e madhe që ekziston midis nivelit minimal dhe maksimal të treguesve, diferencë e cila nga viti 2015 deri në vitin 2020 rezulton të jetë zgjeruar për të gjithë treguesit e konsideruar.

1.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore


Në vijim të masave shtrënguese të ndërmarra për frenimin e përhapjes së COVID-19, situata e emergjencës shëndetësore mori trajtën e një krize ekonomike - sociale, pasojat e të cilës po materializohen ditë pas dite dhe pasqyrohen në tregues makroekonomikë (tregues fiskalë, të borxhit, tkurrjes ekonomike, papunësisë etj.)⁹. Financat vendore, të ardhurat dhe shpenzimet, nuk përbëjnë përjashtim në këtë drejtim.

Në këtë seksion paraqitet një analizë e detajuar e ecurisë së të ardhurave nga burimet e veta vendore nën presionin dhe pasojat e fatkeqësive natyrore që goditën vendin tonë mes viteve 2019 – 2020. Ndër kategoritë e të ardhurave, ato nga burimet e veta vendore (ku janë të përfshira të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, veprimtaritë me asetet etj.) janë një element thelbësor për një qeverisje të mirë dhe të pavarur të bashkive.

Mesatarisht, kjo kategori të ardhurash përfaqësoi rreth 26.8% të burimeve financiare të bashkive gjatë periudhës 2010 – 2020. Në fund të vitit 2020, të ardhurat nga burimet e veta vendore përfaqësuan rreth 26.6% të burimeve financiare totale, vlerë kjo lehtësisht nën mesataren afatgjatë (prej rreth 26.8%).

Në terma nominalë, 61 bashkitë në vend mbledhën rreth 24.2 miliardë lekë në vitin 2020, në rënie me rreth 5.3% krahasuar me nivelin e mbledhur në vitin 2019. Në terma historikë, ky është frenimi i parë i shënuar në të ardhurat nga burimet e veta vendore që prej vitit 2016. Përjashtuar bashkinë Tiranë (e cila përfaqëson rreth 57.7% të të ardhurave nga burimet e veta vendore të vitit 2020), rënia e shënuar në të ardhurat nga burimet e veta vendore të 60 bashkive thellohet më tej në rreth 12.2% në terma vjetorë (shiko grafikun 6).

Grafik 6. Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore



Ngushtimi i të ardhurave në burimet e veta vendore rezulton të ketë ndodhur në rreth 51% të bashkive (apo 31/61 bashki) dhe të luhatet në një interval nga rreth -2% deri në -57.3%. Ndër to, në rreth 77.4% të bashkive (24/31 bashki) rënia e të ardhurave rezulton të jetë mbi 10% në terma vjetorë dhe specifikisht:

- në bashkinë Lezhë u shënua tkurrja më e theksuar në të ardhurat nga burimet e veta vendore me rreth 57.3% në terma vjetorë;
- në bashkitë Kamëz, Fushë Arrëz, Vau i Dejës dhe Kurbin të ardhurat nga burimet e veta vendore shënuan rënie vjetore që luhatet në intervalin - 36% deri në 38% ;
- në bashkitë Vorë, Mallakastër, Klos, Durrës, Skrapar, Kuçovë, Mirditë, Peqin, Kavajë dhe Tropojë të ardhurat nga burimet e veta vendore shënuan rënie vjetore që luhatet në intervalin - 20% deri në -29%;
- në bashkitë Korçë, Dibër, Bulqizë, Roskovec, Libohovë, Krujë, Selenicë, Shkodër dhe Shijak të ardhurat nga burimet e veta vendore shënuan rënie vjetore që luhatet në intervalin - 10% deri në -18%;

Grafik 7. Të ardhura nga burimet e veta vendore sipas bashkive (ndryshime vjetore në %)




Ndonëse zhvillimet negative në kahun e të ardhurave karakterizuan një numër të lartë bashkish përgjatë vitit 2020, kahu i zhvillimeve u përcaktua gjerësisht prej ecurisë së të ardhurave nga burimet e veta vendore të realizuara në bashkinë Lezhë, ndjekur nga bashkitë Kamëz dhe Durrës. Në të kundërt, të dhënat mbi zhvillimet në të ardhurat vendore tregojnë për zhvillime pozitive në të ardhurat nga burimet e veta vendore për 30/61 bashki. Rritja më e theksuar shënohet në bashkitë Pukë dhe Pustec, ku niveli i të ardhurave nga burimet veta vendore rezulton të jetë 2.2 dhe 3.5 herë më e lartë krahasuar me vitin 2019 kryesisht në të ardhurat nga tarifatat vendore dhe të tjera. Rritje e të ardhurave nga burimet e veta vendore u shënuan në bashkitë Dropull (+39.5%), Patos (+33.2%), Konispol (+32%), Has (+31.7%),

Kolonjë (+31.4%) etj.

Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore paraqet interes të veçantë për 11 bashkitë të prekura nga tërmetet e shtatorit dhe nëntorit të vitit 2019 (shiko grafikun 8). Të ardhurat nga burimet e veta vendore në këto bashki kanë shënuar rënie, përjashtuar bashkitë Tiranë dhe Rrogozhinë. Në bashkinë Tiranë, të ardhurat rezultojnë të kenë shënuar rritje me rreth 0.4% në terma vjetorë ndërsa në bashkinë Rrogozhinë norma vjetorë e rritjes së të ardhurave ishte rreth 10.3%. Për vitin 2020, të ardhurat nga burimet e veta vendore rezultojnë në rënie të theksuar për bashkitë: Lezhë (-57.3%), Kurbin (-36.3%), Kamëz (-38.1%), Kavajë (-21.4%) dhe Vorë (-28.7%) dhe Durrës (-24.9%).

Grafik 8. Të ardhura nga burimet e veta vendore 11 bashkitë e prekura nga tërmeti




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Analiza sipas nën-kategorive përbërëse informon për një situatë delikate në lidhje me zhvillimet në mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta vendore përgjatë vitit 2020. Ngushtimi i të ardhurave nga burimet e veta vendore me rreth 5.3% u përcaktua gjerësisht prej rënies në mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Të ardhurat në të dyja këto kategori rezultojnë të jenë tkurrur me rreth 4.8% dhe 6.9% respektivisht në terma vjetorë. Në këtë drejtim vlerësohet të ketë kontribuar frenimi i aktivitetit ekonomik përgjatë periudhës së karantinës (mars – maj 2020), vështirësitë që

aktualisht bizneset po hasin dhe rritjen e papunësisë (largimet nga puna, ulja e orëve të punës etj.), faktorë që ndikojnë në përkeqësimin e gjendjes financiare të bizneseve dhe individëve. Në këto kushte, aftësia paguese e të dy kategorive të taksapaguesve vlerësohet të jetë ndikuar negativisht nga pandemia e COVID-19. Në të kundërt, të ardhurat nga burime të tjera vendore (si menaxhimi i aseteve, gjërat, kamatëvonesat etj.) shënuan rritje vjetore me rreth 15.6% dhe kontribuan pozitivisht në ecurinë e të ardhurave nga burimet e veta vendore (shiko grafikun 9).

Grafik 9. Kontributi sipas kategorive (në p.p.) në ndryshimin vjetor të të ardhurave nga burimet e veta vendore (në %)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Në një vështrim historik, zhvillimet në të ardhurat nga burimet e veta vendore janë përcaktuar gjerësisht nga ecuria e të ardhurave nga taksat vendore. Përa e kësaj kategorie të ardhurash në buxhetet vendore duket të ketë qenë e luhatshme përgjatë pesëvjeçarit të fundit, me zhvendosje në favor të nën-

kategorisë të të ardhurave nga tarifatat vendore. Kjo kategori të ardhurash u godit nga zhvillimet ekonomike të përgjithshme dhe përgjatë vitit 2020 duket të ketë vuajtur ndjeshëm pasojat e tërmeteve dhe të pandemisë së COVID-19. Mbyllja e një sërë biznesesh në bashkitë e prekura nga tërmeti dhe

nga COVID-19, shembja e banesave të dëmtuara nga tërmeti, frenimi i ekonomisë në përgjithësi dhe tkurrja e qarkullimit të bizneseve, shtyrja e afateve të pagesave apo masat fiskale lehtësuese të ndërmarra nga qeveria qendrore dhe bashkitë, për kategori të caktuara, duket të jetë përkthyer në rënie të fluksit të të ardhurave nga taksat vendore me rreth 4.8% për 61 bashkitë në vend. Në mënyrë të ngjashme dhe nën ndikimin e faktorëve të lartpërmendur, zhvillimet në të ardhurat nga tarifave vendore pasqyrojnë rënie vjetore me rreth 6.9%. Peshë dhe kontribut të ulët pozitiv në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga burimet e veta vendore luajtën të ardhurat nga burime të tjera vendore.

Struktura sipas nën-kategorive e të ardhurave nga burimet e veta vendore paraqitet e ndryshme ndërmjet 61 bashkive në vend (paraqitur në grafikun 10). Për të evidentuar këto diferenca, bashkitë do të klasifikohen sipas numrit të popullsisë rezidente në territor (Census 2011), duke identifikuar: (i) bashki të vogla të cilat kanë numër popullsie deri në 40 mijë banorë (43/61 bashki klasifikohen të vogla); (ii) bashki të mesme të cilat kanë nga 40,001 deri në 100,000 banorë (11/61 bashki klasifikohen si të mesme) dhe (iii) bashki mbi 100,000 banorë (7/61 bashki klasifikohen si të mëdha). Duke qenë se popullsia e bashkisë Tiranë diferencon shumë nga bashkitë mbi 100,000 banorë për qëllime analize ajo mbahet e veçantë nga kategoria e bashkive të mëdha (shiko aneksin 4).

Grafik 10. Struktura e të ardhurave sipas përmasës së bashkisë



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Struktura e të ardhurave në bashkitë e vogla tregon për një peshë thuhet të barabartë ndërmjet taksave dhe

tarifave vendore, me rreth 48.2% dhe 48% respektivisht ndaj të ardhurave nga burimet e veta vendore. Në bashkitë e

mesme, tarifat zënë peshën kryesore në të ardhurat nga burimet e veta vendore duke përfaqësuar rreth 55% të tyre. Në të kundërt, në bashkitë e mëdha, janë të ardhurat nga taksat vendore që mbizotërojnë në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore me rreth 57.3% të tyre. Ngjashëm por në një nivel më të lartë, në bashkinë Tiranë, të ardhurat nga taksat vendore përfaqësojnë rreth 70.8% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Alternimi i peshës së kategorive në të ardhurat nga burimet e veta vendore qartësisht tregon për një diferencë të theksuar ndërmjet kapaciteteve fiskale të bashkive, kapacitete të cilat ende nuk po shfrytëzohen plotësisht.


Në nivel bashkie, diferenca në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore janë edhe më të theksuara (paraqitur në grafikun 11). Në bashkitë si Tiranë, Roskovec, Vorë, Fier, Vorë, Klos, Shijak, Cërrik, Lushnje etj., të ardhurat nga taksat vendore përfaqësojnë më shumë se 50% e të ardhurave totale në kategorinë e burimeve të veta vendore. Në të kundërt, në bashkitë Kuçovë, Tropojë, Has, Kukës, Bulqizë, Skrapar, Pukë etj., janë të ardhurat nga tarifave vendore që zënë mbi 50% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Analiza e të ardhurave sipas bashkive për vitin 2020 tregon se rreth 80% e të ardhurave nga burimet e veta vendore mbledhet nga 10 bashki (shiko grafikun 12). Rreth 57.7% e të ardhurave nga burimet e veta vendore u mbledh në bashkinë Tiranë ndjekur më tej nga bashkitë Durrës (rreth 3.8%), Elbasan (rreth 3%), Vlorë (rreth 2.7%), Fier (rreth 2.5%), Shkodër (rreth 2.3%), Korçë (rreth 2.2%) dhe Kamëz (rreth 2%). E njëjta prirje vihet re edhe në peshën që zënë bashkitë në të ardhurat nga taksat

dhe nga tarifat vendore. Rreth 65.8% e të ardhurave nga taksat vendore gjenerohet në bashkinë Tiranë, bashkia më e madhe në vend e cila gëzon numrin më të lartë të bizneseve dhe popullsisë, ndjekur nga bashkitë Durrës (rreth 3.6%) dhe Fier (rreth 3.2%). Rreth 45.3% e të ardhurave nga tarifat vendore gjenerohet në bashkinë Tiranë, ndjekur nga bashkitë Durrës (4.3%), Elbasan (3.9%), Korçë (3.6%) etj.


Ndonëse gëzojnë funksione dhe kompetenca të njëjta (simetrike), bashkitë në vend paraqesin kapacitete financiare shumë të ndryshme ndërmjet tyre, evidentuar nga analiza e detajuar e strukturës së të ardhurave nga burimet e veta vendore (taksave, tarifave dhe të tjera) në nivel bashkie. Rezultatet tregojnë se në mënyrë natyrale janë krijuar disa grupe bashkish ku mund të evidentojmë: (i) bashkinë Tiranë, që operon dhe paraqet diferenca të theksuara me 60 bashkitë e tjera; (ii) bashkitë e mëdha që ndërmjet tyre paraqesin ngjashmëri por diferencojnë shumë nga bashkia Tiranë; (iii) bashki të mesme të cilat paraqesin ngjashmëri mes tyre por kanë diferenca të theksuara me bashkinë Tiranë dhe bashkitë e mëdha; (iv) bashkitë e vogla që paraqesin ngjashmëri mes tyre dhe diferencohen ndjeshëm nga të gjitha bashkitë e tjera. Diferencat në kapacitetet financiare (që në thelb reflektojnë përqendrimin e popullsisë dhe të bizneseve) kushtëzojnë dhe ndikojnë aftësinë e bashkive për të ofruar shërbimet publike vendore për të cilat janë përgjegjëse ligjrisht. Gjithashtu, kjo ndikon gjerësisht në përgjigjen dhe aftësinë e tyre ripërtëritëse në vijim të goditjeve si psh. situata e tërmeteve dhe e pandemisë së COVID-19 apo situatave të fatkeqësive natyrore në përgjithësi.

Grafik 11. Struktura e të ardhurave nga burimet e veta vendore në 61 bashki



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 12. Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas bashkive, viti 2020




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

1.1.1 Të ardhurat nga taksat vendore

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore të bashkive. Në vitin 2020, pesha e këtij zëri ndaj totalit të të ardhurave nga burime të veta vendore ishte rreth 62.7%, raport ky rreth 1.2 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (prej rreth 63.9%) dhe i vlerësuar në rreth 1% ndaj PBB-së nominale.

Në terma nominalë, të ardhurat nga taksat vendore kontribuan me rreth 15.2 miliardë lekë në buxhetin vendor, në rënie me rreth 4.8% krahasuar me një vit më parë. Norma e rritjes së të ardhurave nga taksat vendore thellohet në rreth -14.6% nëse nga totali i tyre do të zbrisnim të ardhurat e mbledhura në bashkinë Tiranë.

Grafik 13. Ecuria e të ardhurave nga taksat vendore




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndonëse në terma të përgjithshëm të ardhurat nga taksat vendore rezultojnë të kenë shënuar zhvillime pozitive, një vështrim i hollësishëm mbi elementët përbërës evidenton dobësitë afatgjata apo varësinë ndaj një numri të kufizuar taksash (shiko grafikun 14). Në tre vitet e fundit, performanca e të ardhurave nga taksat vendore është përcaktuar nga dy elementë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksat mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa, tokë bujqësore, truall).

Ndërkohë që pesha e kësaj të fundit është tkurrur, pesha e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është rritur me ritme të përshpejtuara. Në vitin 2020, këto dy lloje taksash përfaqësuan 85.7% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore. Në të kundërt, pesha dhe kontributi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe i taksave të tjera vijuan tkurrjen edhe përgjatë vitit 2020.

Grafik 14. Të ardhurat nga taksat vendore sipas zërave kryesorë



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe transaksionet e kryera mbi to, përbën një burim të qenësishëm dhe të qëndrueshëm të ardhurash për buxhetin vendor. Në tre vitet e fundit, të ardhurat nga kjo taksë vlerësohen në rreth 0.3% ndaj PBB-së nominale, raport ky ndjeshëm më i ulët krahasuar me mesataren e vendeve të EJT-së prej rreth 0.6% të PBB-së për vitin 2019 (NALAS, 2020). Në vitin 2020, të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme ishin rreth 5.1 miliardë lekë, në rënie me rreth 2% në terma vjetorë, përfaqësuan rreth 33.4% të të ardhurave nga taksat vendore dhe rreth 21% ndaj të ardhurave nga burimet e veta vendore. Ndër kategoritë përbërëse, peshën më të madhe në të ardhurat nga kjo taksë e zenë të ardhurat nga taksa e ndërtesës.

Ndonëse ndër vite të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme (veçanërisht taksa e ndërtesës) kanë ndjekur përgjithësisht prirje rritëse, problematikat e lidhura

me të drejtat e pronësisë dhe mungesës së regjistrave kadastralë, ndër të tjera, pengojnë shfrytëzimin e plotë të potencialit të kësaj takse. Në vijim të reformimit rrënjësor të kësaj takse nëpërmjet Ligjit nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, 'Për sistemin e taksave vendore', të ndryshuar", viti 2019 pritej të ishte dhe viti kur të gjitha bashkitë në vend do të aplikojnë taksën e pronës sipas metodologjisë të re, bazuar në komunikimet në media të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Aktualisht, jo të gjitha bashkitë e kanë ndërmarrë këtë hap, si pasojë e problematikave në mbledhjen e të dhënave të nevojshme për aplikimin e kësaj metodologjie.

Ecuria vjetore e të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme paraqet zhvillime pozitive në 33/61 bashki në vend (shiko grafikun 16). Rritja më e lartë në të ardhurat nga kjo taksë u shënuar në bashkitë Belsh (+32.7%), Pukë (+43.9%), Mirditë (+40.9%),

Grafik 15. Të ardhurat nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Kolonjë (+29.2%) etj. Në të kundërt, të ardhurat nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme rezultojnë në rënie në 23/61 bashki si: Vlorë (-29.6%), Peqin (-26.4%), Patos (-26.1%), Durrës (-26%), Divjakë (-25.8%), Vau i Dejës (-24.3%) etj. Të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme paraqesin nivel të lartë përqendrimi në një grup të kufizuar bashkish (shiko grafikun 17). Rreth 45.5% e të ardhurave nga taksa për pasuritë e paluajtshme mbledhet në bashkinë Tiranë, rezultat i përqendrimit të një numri të lartë banesash dhe ndërtesash në këtë territor. Bashkia Durrës renditet e dyta për nga pesha në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme me rreth 5.4% ndaj totalit për periudhën e konsideruar, ndjekur nga bashkitë Fier, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër.

Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat zënë peshën më të madhe në totalin nga të ardhurat nga taksat mbi pasurinë

e paluajtshme (mesatarisht 75% në tre vitet e fundit, grafiku 18 majtas). Rreth 50.4% e të ardhurave totale nga taksa e ndërtesës u mbledhën në bashkinë Tiranë ndjekur nga bashkitë Durrës (4.7% ndaj totalit) dhe Elbasan (4.4% ndaj totalit).


Për vitin 2020, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një nivel prej rreth 3.8 miliardë lekë, në rënie me rreth 3.1% në terma vjetorë. Gjatë vitit 2020, të ardhurat nga taksa e ndërtesës shënuan rënie në 35/61 bashki në vend dhe veçanërisht në bashkitë Devoll (-79.4%), Memaliaj (-61.8%), Mallakastër (-52.4%), Divjakë (-52%) etj. Ndër bashkitë e goditura nga tërmetet e fundit të vitit 2019 në bashkitë Durrës, Kurbin dhe Peqin u shënuan rënie e të ardhurave nga taksa e ndërtesës. Në të kundërt, në bashkitë Krujë, Kamëz, Tiranë, Rrogozhinë normat e rritjes u moderuan disi krahasuar me një vit më parë por vijuan të jenë pozitive.

Grafik 16. Të ardhura nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme sipas bashkive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 17. Pesha e bashkive në të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Megjithatë, niveli aktual i të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë tregon se rezultatet e reformës dhe metodologjisë së re, ende nuk janë materializuar. Në mungesë të informacioneve të detajuara, ecuria aktuale e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat mund të interpretohet në disa mënyra: (i) metodologjia e re e cila solli një rritje të barrës fiskale mund të ketë krijuar pamundësi për pagesën e kësaj takse nga taksapaguesit dhe të ketë rritur nivelin e mos-pagesës së saj; (ii) metodologjia e re mund të ketë ulur - rritur barrën fiskale nga një kategori taksapaguesish tek tjetra, me rezultante kompensuese të njëra - tjetrës, pra me efekt të papërfillshëm në total; (iii) me aplikimin e metodologjisë së re, nuk është arritur të rritet baza e taksueshme sidomos në ato bashki që po përdoret UK si agjent tatimor (dhe mund të ketë ende lidhje të paligjshme/ të paregjistruara) apo jo e gjithë popullata është e mbuluar me shërbim; (iv) ndodhitë që karakterizuan fundin e

vitit 2019 (tërmetet e njëpasnjëshme) dhe pandemia e COVID-19 mund të kenë ndikuar negativisht në kryerjen e pagesave për këtë taksë nga taksapaguesit.

Të ardhurat nga taksa mbi *tokën bujqësore*, ndonëse me peshë ndjeshëm më të ulët sesa të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën, kontribuan me rreth 543.7 milionë lekë (në rritje me rreth 5.1% në terma vjetorë) në kategorinë e të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme. Në ndryshim nga elementi i përqendrimit të të ardhurave nga taksa e ndërtesës në një numër të kufizuar bashkish, të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore rezultojnë të jenë të shpërndara ndërmjet bashkive. Niveli më i lartë i kësaj takse u mbledh në bashkinë Fier (rreth 14.1% e totalit), Lushnjë (rreth 10.7% e totalit) dhe Divjakë (rreth 4.7% e totalit), lidhur dhe me karakterin bujqësor të ekonomive të këtyre bashkive.

Grafik 18. Të ardhura nga taksat mbi ndërtesën dhe tokën bujqësore, viti 2020



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga taksa e truallit zënë një peshë të ulët në totalin e të ardhurave nga taksat e pronës (rreth 3.1%) dhe shënuan rritje me rreth 8.2% në terma vjetorë.

Të ardhurat nga taksa mbi transferimin e të drejtave të pronësisë shënuan rënie me rreth 3.2% në terma vjetorë në fund të vitit 2020.

Elementi i dytë i rëndësishëm në të ardhurat nga taksat vendore përfaqësohet nga të hyrat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Të hyrat nga kjo taksë vijojnë të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm dhe qenësishëm në buxhetin vendor (më i lartë edhe se të ardhurat nga taksat e pronës):

në vitin 2020 të ardhurat nga kjo taksë përfaqësuan rreth 52.2% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore, rreth 32.8% ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe u vlerësuan në rreth 0.5% të PBB-së nominale.


Zgjerimi i peshës së këtij zëri në buxhetet vendore vlerësohet të jenë ndikuar ndjeshëm nga zbatimi i PPV-ve nëpërmjet lejeve të ndërtimit për ndërtesa të reja veçanërisht në tre vitet e fundit: në vitin 2018 u dhanë 1,194 leje, në vitin 2019 rreth 1,094 leje dhe për gjashtë muajt e parë të vitit 2020 ishte 393 leje.¹⁰ Zbatimi i Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) nëpërmjet lejeve të reja të ndërtimit, nga një anë, ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga TNI për bashkitë, nga ana tjetër, i vendos ato në një pozicion

sfidues për ofrimin e infrastrukturave të nevojshme publike, të cilat gjithashtu kërkojnë financime si në zhvillim fillestar ashtu dhe në mirëmbajtje të vazhdueshme.¹¹

Pas një rritje me ritme dyshifrore, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

shënuan një nivel prej rreth 7.9 miliardë lekë, në rënie me rreth 6.1% në terma vjetorë, ose rreth 514 milionë lekë më pak krahasuar me vitin e mëparshëm. Përfshirë të ardhurat e arkëtuara nga bashkia Tiranë, 60 bashkitë e tjera në vend mbledhën rreth 1.5 miliardë lekë nga TNI, me rënie të theksuar në terma vjetorë me rreth 30%.

Grafik 19. Ecuria e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Performanca në të ardhurat prej kësaj takse sugjeron për vijimësi të presioneve zhvillimore matur nga numri i lejeve të ndërtimit, ndonëse ky presion është përqendruar kryesisht në bashkinë Tiranë (rreth 24.2% e totalit të lejeve të dhëna në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020). Ndonëse në terma të të ardhurave të gjeneruara nga TNI dhe nga numri lejeve të ndërtimit të dhëna situata paraqitet dinamike

dhe me zhvillim të përsheptuar, në perceptimin e bizneseve të sektorit të ndërtimit, përafëruar nga treguesi i besimit në ndërtim (TBN), situata vijon të jetë thellësisht negative (shiko grafikun 20). Në periudhën në analizë, TBN qëndroi në territor negativ duke sugjeruar për një situatë negative të perceptuar në këtë sektor në fund të vitit 2020.

Grafik 20. Tregues të zhvillimeve në sektorin e ndërtim




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Banka e Shqipërisë

Megjithatë, ndonëse deri në vitin 2017 treguesi i TBN-së dhe i të ardhurave nga TNI në total paraqesin korrelacion të mirë ndërmjet tyre, në vitet në vijim ecuria e tyre është e ndryshme. Kjo diferencë rezulton të përcaktohet nga ecuria e të ardhurave nga TNI në bashkinë Tiranë, veçanërisht pas vitit 2017 dhe rritjes në vijim. Në të kundërt, të ardhurat nga TNI për 60 bashkitë e tjera në vend dhe TBI paraqesin korrelacion në kohë.


Në nivel mesatar, të ardhurat nga TNI (nga ndërtimet e reja dhe të ardhurat nga legalizimet) kanë rritur në mënyrë progresive kontributin e tyre në buxhetet vendore (shiko grafikun 21). Në periudhën 2010-2015, të ardhurat nga TNI përfaqësuan mesatarisht rreth 25.6% të të ardhurave totale nga taksat vendore dhe në periudhën 2016-2020 pesha e tyre u rrit në rreth 44.6% të të ardhurave nga taksat vendore. Në fund të vitit 2020, të ardhurat totale nga TNI nga 61 bashkitë përfaqësuan rreth 52.2% të të ardhurave nga taksat vendore. Për rreth 8% të bashkive ose 5/61 bashki, të ardhurat nga kjo taksë qëndrojnë mbi mesataren kombëtare të raportit TNI/të ardhura nga taksat vendore: bashkitë Himarë (82.6%), Tiranë (64.6%), Malësi e Madhe (59.1%), Kamëz (57.2%) dhe Sarandë (53.2%). Në bashkinë Vlorë, raporti i të ardhurave nga TNI ndaj taksave kombëtare shënon një nivel pranë mesatares kombëtare. Ndërkohë, në rreth 21% të bashkive ose 13/61 bashki të ardhurat nga kjo taksë përfaqësojnë më pak se 10% të të ardhurave nga taksat vendore duke reflektuar deri diku edhe presione më të ulëta zhvillimi apo mungesë kërkesë për zhvillime të reja.

Ndonëse me peshë të madhe në të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga TNI nuk realizohen njëtrajtësisht në të gjitha bashkitë (shiko grafikun 22). Rreth 80.4% e të ardhurave nga kjo taksë u mbledh në bashkinë Tiranë dhe diferenca në 60 bashkitë e tjera në vend. Në vitin 2020, bashkia Tiranë arkëtoi rreth 6.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 2.4% në terma vjetorë. Me diferencë të theksuar nga bashkia Tiranë, bashkia Vlorë mbledhi rreth 2.5% të të ardhurave nga TNI për vitin 2020 ndjekur nga bashkitë Durrës (rreth 2.4%) dhe Himarë (rreth 2.0%). Bazuar në informacionin për lejet e ndërtimit të dhëna në gjashtë muajt e parë të vitit 2020, në bashkinë Tiranë do të shtohen rreth 520 mijë metër katrorë sipërfaqe ndërtimore të reja apo rreth 79% e sipërfaqes totale ndërtimore të re në Shqipëri. Këto të dhëna, konfirmojnë sërish për karakterin specifik të kësaj bashkie dhe diferencën e të krijuar midis bashkisë Tiranë dhe 60 bashkive të tjera në vend.

Grafik 21. Rëndësia e të ardhurave nga TNI në buxhetet vendore



Grafik 22. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total = 100%)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Taksa e ndikimit në infrastrukturë është shndërruar në një burim të qenësishëm i të ardhurave në buxhetin vendor, veçanërisht në bashkitë e mëdha si Tirana, Durrësi, Himara, Lezha etj. Rritja e kontributit të kësaj takse në buxhetin vendor do të kërkonte njëkohësisht parashikime dhe angazhime afatmesme deri/dhe afatgjata në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike vendore për zhvillimet e reja. Në total, në gjashtë muajt e parë të vitit 2020 janë shtuar rreth 656 mijë metër katror ndërtime të reja të cilat do të duhej të shoqëroheshin me infrastruktura publike mbështetëse. Gjithashtu, duke qenë një burim të ardhurash jo i vazhdueshëm, bashkitë duhet të gjejnë zgjidhje dhe të aftësohen për t'u bërë ballë detyrimeve financiare të sotme dhe atyre të ardhshme, përballë një buxheti të kufizuar – kjo do të krijonte kushte të favorshme dhe do të ishte në përputhje me konceptin e barazisë ndër-gjeneracionale. Praktikisht, të ardhurat e realizuara sot nga kjo taksë do të duhej të investoheshin për të siguruar infrastrukturën e nevojshme

publike si dhe operimin e tyre në të ardhmen, pa rënduar në buxhetet e gjeneratave të ardhshme.

Të ardhurat nga *tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël*, dikur një burim financiar i rëndësishëm në buxhetet vendore (në vitin 2015, të ardhurat nga kjo taksë përfaqësonin rreth 24.7% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore, ndërsa, në vitin 2020 ato përfaqësuan rreth 2.6% të tyre), vijnë të tkurrin kontributin e tyre në mënyrë progresive (paraqitur në grafikun 23).

Në terma nominalë, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një vlerë prej rreth 387 milionë lekë në 2020, me një rritje prej 3.1% krahasuar me vitin 2020. Në terma afatgjatë, të ardhurat nga kjo taksë pritet të ulin në mënyrë progresive kontributin e tyre në totalin e të ardhurave nga burime të veta vendore.¹³ Në vijim të vështirësive të krijuara nga pandemia e COVID-19 dhe për të stimuluar biznesin e vogël, pjesë e propozimeve të politikës fiskale është

Grafik 23. Ecuria e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

dhe heqja e kësaj takse deri në vitin 2029.¹⁴ Ndërkohë, bazuar në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" në nenin 4, pika 6 citohet se:

"Në rastet kur ulen apo hiqen taksa ose tarifa vendore nga qeverisja qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen plotësisht, nëpërmjet rritjes së tranfertës së pakushtëzuar, taksave të ndara, transferimit në nivel vendor të një takse tjetër kombëtare ose kombinimi i tyre."


Gjithashtu, ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 34 mbi parimet themelore për financat e vetëqeverisjes vendore, pika 5 citohet:

"Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera."

Ndonëse ligjërisht, qeveria qendrore ka detyrim të kompensojë bashkitë për të ardhurat e munguara, që prej vitit 2016 kjo gjë nuk duket të ketë ndodhur. Gjithashtu, mbetet për t'u parë nëse dhe si do të rishikohet formula për ndarjen e transfertës së të pakushtëzuar, pasi kjo taksë është përdorur për të siguruar ekualizimin horizontal efektiv ndërmjet 61 bashkive (për të konsideruar diferencat ekzistuese në kapacitetin fiskal të bashkive).

Ndonëse në masë më të ulët (0.6% e të ardhurave nga taksat vendore), të ardhurat nga taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier kontribuan negativisht në ecurinë e përgjithshme e të ardhurave nga taksat vendore. Për vitin 2020, të ardhurat nga kjo taksë shënuan një nivel prej rreth 94.7 milionë lekë, në rënie të theksuar me rreth 62.1% në terma vjetorë. Kjo rënie vlerësohet të jetë rezultat i masave shtrënguese të aplikuara nga qeveria qendrore në kuadër të frenimit të përhapjes së pandemisë së COVID-19 në vend. Lëvizjet e kufizuara dhe mbyllja e kufijve përcaktuan ngushtimin në të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë në buxhetet vendore.

Grafik 24. Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Për vitin 2020, rreth 38.6% e të ardhurave nga taksa e hotelit u mbledhën në bashkinë Tiranë, ndjekur nga bashkia Sarandë me rreth 11.7% të të ardhurave totale të mbledhura nga kjo taksë (shiko grafikun 24). Niveli i të ardhurave të mbledhura nga taksa

mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier qëndron ndjeshëm nën potencialin e kësaj takse, veçanërisht në periudhën përpara pandemisë së COVID-19 dhe bashkitë me potencial të lartë turistik. Në vendin tonë, numri i turistëve ka njohur rritje me ritme të përshpejtuara,

çka duket të mos jetë përkthyer në rritje të të ardhurave për buxhetet vendore nga taksa e hotelit (shiko grafikun 25). Bazuar në legjislacionin në fuqi, baza e taksës është numri i netëve të qëndruara në hotel (e llogaritur si lekë për natë fjetje në hotel për person). Varësisht tipologjisë së strukturës akomoduese dhe kategorisë së bashkisë, taksa e fjetjes në hotel është

140 lekë dhe 350 lekë në bashkitë e kategorisë së parë (Tiranë dhe Durrës), 70 lekë dhe 175 lekë në bashkitë e kategorisë së dytë (Vlorë, Fier, Sarandë, Pogradec, Korçë, Elbasan, Berat, Lushnjë, Gjirokastër, Shkodër, Kavajë dhe Lezhë) dhe 35 lekë dhe 105 lekë në bashkitë e kategorisë së tretë (të gjitha bashkitë e tjera përjashtuar bashkitë e kategorisë së parë dhe të dytë).

Grafik 25. Turizmi dhe të ardhurat nga taksa e hotelit (ndryshime vjetore).



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Një problem shqetësues në sektorin e turizmit është informaliteti i cili shfaqet në forma të ndryshme si mos regjistrimi i strukturave akomoduese apo kapaciteteve reale, mos deklarimi i netëve qëndrimeve apo deklarimi i numrave fiktivë etj. Sipas Kristo (2013) dhe FSHZH (2018), ekziston një hendek i madh në numrin e strukturave akomoduese të deklaruar përkundëjt atyre që realisht ushtrojnë aktivitetin në territor.

Në mungesë të formalizmit të sektorit, bashkitë humbasin çdo vit të ardhura për buxhetet e tyre, të ardhura të cilat mund të përdorshin për përmirësimin e strukturave dhe infrastrukturave turistike.

Hapësirë informuese 2

Fuqia taksuese e bashkive.

Në hapësirën informuese 1 u paraqitën tre tregues të cilët përdoren për të vlerësuar autonominë fiskale dhe financiare të bashkive në vend. Krahas tyre, përparimi i decentralizimit fiskal u vlerësua duke përdorur tregues të të ardhurave ndaj PBB-së dhe ndaj të ardhurave të qeverisë së përgjithshme. Bazuar në këto tregues, u vlerësua për një nivel të ulët të autonomisë financiare të bashkive në vend dhe për një decentralizim fiskal i cili ende nuk duket të jetë materializuar. Për një vlerësim më të drejtë dhe të qartë të autonomisë së bashkive në kahun e të ardhurave, është e rëndësishme të gjykojmë mbi një sërë elementësh të tjerë si autonomia në përcaktimin e nivelin e taksës dhe/ose tarifës, bazën e taksueshme, lehtësitë e aplikueshme etj. Për këtë qëllim, do të aplikojmë metodologjinë e zhvilluar nga OECD-ja (OECD, 2020) për të vlerësuar mbi autonominë e bashkive në taksim apo fuqinë taksuese të bashkive në Shqipëri.

Sipas OECD-së, një nga përparësitë ekonomike dhe politike të decentralizimit të financave publike vjen pikërisht nga mundësia e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për të marrë vendime mbi taksimin. Sa më shumë hapësirë të ketë njësi e vetëqeverisjes vendore në përcaktimin e nivelit të taksës, bazës së taksueshme dhe karakteristika të tjera të taksës, aq më e lartë autonomia apo fuqia e saj taksuese. Për këtë qëllim, OECD ka krijuar një sistem kodimi për të mund të vlerësuar sa autonomi kanë NjQV-të në taksim, në një rend rënës të saj nga më i larti tek më i ulëti.

Në Shqipëri, të ardhurat që bashkitë përftojnë nga taksat janë të rregulluara në dy ligje të rëndësishëm: ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe ligji nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. Bazuar në dy ligjet e sipërcituara bashkitë gëzojnë të ardhura nga taksat vendore të cilat gjenden të përmbledhura në tabelën 2. Nga një vështrim krahasues i tyre, vërehet nevoja për rregullime dhe njehsim në terminologji dhe në përmbajtje midis

dy ligjeve të cilat referojnë taksat vendore. Kjo është e vlefshme në rastin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme, ku krahas ndërtesës, tokës bujqësore dhe truallit, ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" përmban dhe "*mbi transaksionet e kryera me to*". Gjithashtu, në ligjin nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar listohet ndër taksat vendore "taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme", që nuk listohet në ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Në këtë të fundit, renditet si taksë vendore "Taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore" dhe "taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë" klasifikohet si taksë e ndarë. Për të mënjeluar çdo paqartësi, do të ishte rasti i njehsimit të terminologjisë dhe përcaktimeve në çfarë përbën taksë vendore dhe çfarë përfshihet në taksat e ndara.

Tabelë 2. Taksat vendore në Shqipëri

Sipas ligjit 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore"	Sipas ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	Taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to
Taksa e fjetjes në hotel	Taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	
Taksa e tabelës	Taksa e tabelës
Taksa të përkohshme	Taksa vendore të përkohshme
	Taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore
	Taksa të tjera, të përcaktuara me ligj

Duke qenë se të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara përdoren në autonomi nga bashkitë, në matricën e vlerësimit të fuqisë/autonomisë taksuese të bashkive do të përfshijmë edhe taksat e ndara:

- Taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë (ku bashkitë përftojnë 97% e të ardhurave);
- Taksën vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura (ku bashkitë përftojnë 25% të të ardhurave);
- Rentën minerare (ku bashkitë përftojnë 5% të të ardhurave);
- Tatimin mbi të ardhurat personale (ku bashkitë përftojnë 2% të të ardhurave).

Të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara përdoren në autonomi të plotë nga bashkitë (neni 4 i ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Ndërkohë, ligji për taksat kombëtare citon që e ardhura nga renta minerare duhet të përdoret për investime. Ndërkohë, për të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në nenin 12 pika 4 përcaktohet se të ardhurat prej kësaj takse "*...kryesisht, përdoren për financimin e investimeve publike*".

[illegible]

Bazuar në vlerësimet e përfshira në tabelën 3 vlerësojmë se bashkitë në Shqipëri kanë fuqi taksuese të ulët. Të drejtën e përcaktimit të bazës së taksueshme (vlera e taksës së pasurisë së paluajtshme) dhe nivelit të taksës (jo më shumë se 35% e bazës së taksueshme) dhe karakteristikave të tjera, bashkitë e kanë vetëm në rastin e taksës së përkohshme (në përputhje me parashikimet dhe kuadrin rregullator në fuqi) ndaj dhe fuqia taksuese bie në kategorinë B2. Fuqia taksuese për taksën vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël) dhe taksën vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier është tërësisht e qendëruar dhe klasifikohet në kategorinë E. Për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe taksën e tabelë, niveli i taksës dhe baza e taksueshme janë të përcaktuara në nivel qendror ndërkohë që bashkitë mund të përdorin kategorizime dhe nën-kategorizime për vendosjen e nivelit të taksës (fuqia taksuese bie në nivelin C). Në lidhje me taksën e pronës, baza e taksueshme dhe niveli i taksës dhe elementë të tjerë janë të përcaktuar nga qeveria qendrore. Bashkitë (Këshilli Bashkiak) ka të drejtë të vendosë mbi nivelin e taksës në kufijtë prej +/-30% të nivelit tregues të taksës sipas kategorive ndaj dhe mund të klasifikohet në kategorinë C. Në vlerësimin e fuqisë taksuese në lidhje me taksat e ndara, vlerësimet e kryera sugjerojnë se bashkitë nuk kanë asnjë kontroll mbi nivelin e tyre ndaj dhe klasifikohen në kategorinë D4.

Nisur nga vlerësimet e përafërta mbi fuqinë taksuese të bashkive në Shqipëri, mund të themi që ato që quhen taksa vendore, janë të përcaktuara në nivel të qendëruar. Thënë ndryshe bashkitë nuk kanë zë

në përcaktimin e bazës së taksueshme dhe nivelin e taksës. Maksimalisht, bashkitë mund të vendosin mbi kategorizime apo nën-kategorizime dhe lehtësi të tjera që lidhen me afatet, përjashtime apo mënyrat e pagesës. Në mënyrë të ngjashme, taksat e ndara janë nën vendimmarrjen e qeverisë qendrore dhe bashkitë nuk kanë zë në përcaktimin e tyre. Për më tepër, kur qeveria qendrore ndërmerr ndryshime fiskale që lidhen me këto taksa, bashkitë nuk kompensohen për diferencë me burime të tjera financiare.

1.1.2 Të ardhurat nga tarifat vendore


Të ardhurat nga tarifat vendore përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të hyrash në buxhetin vendor, mbi të cilat bashkitë kanë autonomi të plotë vendimmarrje (në përcaktimin e bazës, nivelit, lehtësive dhe përdorimit të tyre). Megjithatë, ky burim mjetesh financiare paraqet luhatshmëri të lartë ndaj goditjeve të brendshme dhe/ose të jashtme (si ishin tërmetet dhe pandemia e COVID-19). Nën presionin e pandemisë së COVID-19, bashkitë u gjendën përballë sfidës së përshtatjes së mënyrës së të punuarit nën kufizimet e vendosura dhe vijimësisë së ofrimit të shërbimeve publike vendore thelbësore dhe atyre të diktuar nga situata e krizës shëndetësore. Bazuar në gjetjet nga vërtetimi i përgjithshëm me bashkitë, një pjesë e shërbimeve u ofrua në modalitetin virtual (psh. planifikimi dhe menaxhimi i territorit, arsimit etj.); shërbime si gjendja civile, aktivitetet kulturore, one-stop-shops, sportet, turizmi, transporti publik etj. u pezulluan; dhe shërbime si mbrojtja civile, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, shërbimet e mbrojtjes sociale etj. vijuan

të ofrohen pavarësisht vështirësive (Toto, Toska, Shutina, Farrici, & Limaj, 2020). Në këtë kontekst, mbi 80% e bashkive paraqiste pritshmëri negative në lidhje me mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta dhe specifikisht për tarifat e pastrimit, gjelbërimit, zënien e hapësirave publike etj. (Toto, et al., 2020: p.30). Të dhënat për ecurinë e të ardhurave nga tarifat vendore gjatë vitit 2020 janë në linjë me pritshmëritë e tyre.

Në total, të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2020 shënuan një nivel prej

8.7 miliardë lekë, në rënie me rreth 6.9% në terma vjetorë kryesisht si pasojë e rënies së të ardhurave nga tarifa për zënien e hapësirave publike dhe tarifave të tjera administrative. Përjashtuar të ardhurat e gjeneruara nga bashkia Tiranë (rreth 46% në vitin 2020), norma vjetore e rënies së të ardhurave nga tarifat vendore për 60 bashkitë e tjera në vend thellohet më tej në rreth 10% në terma vjetorë. Kjo rënie vlerësohet të jetë e konsiderueshme dhe vlerësohet të çënojë deri diku qëndrueshmërinë në ofrimin e shërbimeve publike (të paktën ato më thelbësoret).

Grafik 26. Ecuria e të ardhurave nga tarifat vendore




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, rënia e nivelit të të ardhurave nga tarifat vendore ishte e pranishme në 32 nga 61 bashki (shiko grafikun 27) ndonëse, kontributin kryesor në këtë drejtim e dha rënia e të ardhurave nga tarifat vendore në bashkitë Kamëz (me rreth -53.5%),

Tiranë (me rreth -2.9%), Durrës (me rreth -20.2%) dhe të tjerë. Në të kundërt në bashkitë si Patosi, Pusteci, Puka, Belshi Ura Vajguore etj. të ardhurat nga tarifat vendore shënuan norma rritjeje pozitive.


Grafik 27. Ecuria e të ardhurave nga tarifatat vendore sipas bashkive, viti 2020

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Sipas zërave kryesorë, të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve përfaqësojnë rreth 50% të të ardhurave totale nga tarifatat, të ardhurat nga tarifatat administrative dhe të tjera përfaqësojnë rreth 36.7% dhe të ardhurat nga tarifa për zënie dhe shfrytëzimin e hapësirave publike rreth 13.3%. Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve publike (menaxhimi i mbetjeve, ndriçimi dhe gjelbërimi, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, ujëtimi dhe kullimi) regjistruan një vlerë prej rreth 4.3 miliardë lekë, në rritje të lehtë me rreth 0.4% në terma vjetorë. Rreth 88.4% e të ardhurave nga tarifatat për shërbimet publike u mbledhën nga tarifa e pastrimit dhe higjienës. Në tre vitet e fundit, të ardhurat

nga tarifa e pastrimit dhe higjienës kanë shënuar luhajtje të vogla duke ruajtur një nivel mesatar prej rreth 3.8 miliardë lekë në vit duke sugjeruar për një amortizim të efektit të rritjes së kësaj tarife nga disa bashki. Në shumë bashki, mbledhja e kësaj tarife kryhet duke përdorur si agjentë tatimorë kompanitë e UK-ve (në zonat urbane kryesisht dhe aty ku ekziston rrjeti i furnizimit me ujë). Ndërkohë, ende nuk duket që të ardhurat nga tarifatat vendore të pasqyrojnë kostot shtesë për depozitimin në landfille (ku për ton mbetje të depozituar aplikohet një tarifë e caktuar) dhe/ose transferimin e tyre në inceneratorë për djegie.

Grafik 28. Ecuria e të ardhurave nga tarifatat vendore

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik regjistruan një nivel prej rreth 285.6 milionë lekë duke përfaqësuar rreth 6.6% ndaj totalit nga tarifatat e shërbimeve publike. Në të kundërt, të ardhurat nga tarifa për shërbimin e ujëtitjes dhe të kullimit ndonëse kanë

peshë të ulët ndaj totalit të të ardhurave nga tarifatat vendore, shënuan rritje të theksuar krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga kjo tarifë në vitin 2020 ishin rreth 21.8 milionë lekë nga rreth 5.8 milionë lekë në vitin 2019. Kjo tarifë mbledhet në masë më të gjerë në

bashkitë Elbasan, Berat, Korçë, Lushnje dhe Ura Vajgurore etj. në përputhje dhe me karakterin ekonomik bujqësor të tyre.

Të ardhurat nga tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave rezultojnë me ulje në periudhën në analizë duke shënuar një vlerë prej 1.2 miliardë lekë në vitin 2020, në rënie

Tabelë 4. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive

	Në vlerë (lekë)	Pesha ndaj totalit
Tarifë pastrimi dhe higjiene	3,833,184,250	88.4%
Tarifa për ndriçimin publik	285,609,935	6.6%
Tarifa për gjelbërimin	197,479,253	4.6%
Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet	413,654	0.0%
Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	21,813,934	0.5%
Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	3,833,184,250	100%

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

me rreth 16.2% në terma vjetorë. Nëse do të shikonim performancën e zërave specifikë, rezultojnë se të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi (bare dhe restorante) zënë peshën më të lartë me rreth 49.2% të totalit, ndjekur nga të ardhurat nga tarifa për parkime me 41.5%. Lidhur me të ardhurat nga tarifa për parkime, vlen për t’u përmendur fakti se vetëm bashkia Tiranë mbledh rreth 83.5% të të ardhurave totale nga kjo tarifë, ndjekur nga bashkia Durrës me rreth 3.9%. Në këtë drejtim, bashkitë e tjera të mëdha, qendra qarku, nuk kanë patur të njëjtin performancë, ndonëse kanë potencial (duke konsideruar numrin e popullsisë dhe të automjeteve).

1.1.3 Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura¹⁵

Në mungesë dhe/ose pamjaftueshmëri të mjeteve financiare, bashkitë mund të marrin hua afatshkurtër për mbulimin e nevojave për likuiditet afatshkurtër ose afatgjatë me qëllim financimin e shpenzimeve kapitale apo ri-financimin e një huaje ekzistuese. Termat dhe kushtet për të aksesuar hua nga qeverisja vendore në Shqipëri janë specifikisht të rregulluara në ligjin nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”. Aksesimi në burime financiare të jashtme është një tregues për autonominë në kahun e të ardhurave (qoftë në trajtën e huasë afat-shkurtër dhe/ose afatgjatë dhe/ose PPP-ve) sipas OECD-së.

Bazuar në të dhënat e publikuara në regjistrin e borxhit në fund të vitit 2020, rezultojnë se bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë, Elbasan, Lezhë kanë hua aktive në sistemin bankar vendas.¹⁶ Të gjitha huatë e lartpërmendura janë kontraktuar në vitin 2010 (bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë dhe Elbasan) dhe

vitin 2014 (bashkitë Korçë dhe Lezhë), me qëllim financimin e projekteve infrastrukturore. Pas vitit 2014, asnjë bashki nuk rezultojnë të ketë marrë hua, ndonëse nevojat për investime janë të mëdha dhe buxhetet kapitale të bashkive të pamjaftueshme.

Tabelë 5. Të dhëna mbi huamarrjen vendore

Huamarrësi	Huadhënësi	Shuma (në milionë lekë)	Nënshkruar më:	Përfundon më:	Stoku në fund të vitit 2019: (në milionë lekë)	Stoku në fund të vitit 2020: (në milionë lekë)
Bashkia Korçë	Pro Credit	100	2010	2020	16.3	6.0
Bashkia Korçë	ISBA	200	2014	2024	121.4	99.0
Bashkia Pogradec	Pro Credit	113	2010	2020	5.7	0.6
Bashkia Vlorë	BKT	420	2010	2020	35.3	20.3
Kom. Petrelë	BKT	15	2010	2019	-	-
Bashkia Elbasan	BKT	800	2010	2020	364.2	277.4
Bashkia Lezhë	ISBA	107	2014	2023	38.8	28.9


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021

Në total, stoku i borxhit të qeverisjes vendore në fund të vitit 2020 rezultojnë të jetë rreth 432 milionë lekë ose rreth 0.026% ndaj PBB-së¹⁷ dhe jep një kontribut të vogël në shifrën e borxhit publik të përgjithshëm. Krahësohet me të dhënat për vitin 2019, rezultojnë se bashkitë kanë ulur ekspozimin e tyre ndaj bankave me rreth 150 milionë lekë, në varësi të planeve përkatëse për

shlyerjen e huave. Ndonëse ekspozimi i bashkive në huamarrje është i ulët dhe luan një rol modest në borxhin e përgjithshëm të Shqipërisë, asnjë nga bashkitë në vend që prej vitit 2014 nuk ka marrë hua. Kjo, jo vetëm për kushtet që duhen plotësuar por edhe në vijimësi të trajektoreve të konsolidimit fiskal të ndërmarrë nga MFE. Kjo e fundit duket të ketë kufizuar hapësirën

për huamarrje të re për bashkitë, për sa kohë borxhi vendor rrit nivelin e përgjithshëm të borxhit publik (shiko grafikun 29).

Grafik 29. Borxhi publik përkundëjt kriterit të Mastrokittit



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë & përpunime të autorëve

Ndërkohë, krahas treguesve të borxhit, bashkitë në vend mbartin ndër vite stokun e detyrimeve të prapambetura, të cilat në fund të vitit 2020 u vlerësuan në rreth 6.9 miliardë lekë, 16 herë më i lartë se stoku i borxhit të qeverisjes vendore. Në raport ndaj PBB-së, detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2020 përfaqësuan rreth 0.42% nga një nivel prej rreth 0.5% një vit më parë. Detyrimet e prapambetura të bashkive u evidentuan në mënyrë sistematike duke filluar prej vitit 2015, në vijim të miratimit të VKM nr. 50/2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit" dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5/2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Shlyerja u këtyre detyrimeve, pjesërisht të krijuara nga


ish-komunat që iu bashkëngjitën bashkive të reja në vijim të reformës administrative dhe territoriale, përbën barrë të qenësishme për buxhetet vendore. Krahas tyre, bashkitë vijnë të krijojnë detyrime të reja të cilat gjithashtu shtojnë presionet në buxhetin vendor. Në këtë kuadër, qeveria qendrore merr përsipër vetëm:

"shlyerjen e detyrimeve për punimet e kryera, por të papaguara në kuadër të financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njësive të qeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njësive të qeverisjes vendore."

Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në fund të vitit 2015, stoku i detyrimeve të prapambetura ishte rreth 12.1 miliardë lekë, vlerë kjo shqetësuese si në nivel vendor ashtu dhe në nivel qendror. Që prej vitit 2015, stoku i detyrimeve të

prapambetura ka ndjekur prirje rënëse dhe në vitin 2020 shënoi një nivel prej rreth 6.9 miliardë lekë, në rënie vjetore me rreth 15.2% apo rreth 1.2 miliardë lekë më i ulët se niveli i shënuar në fund të vitit 2019.

Grafik 30. Stoku i detyrimeve të prapambetura ndër vite




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë & përpunime të autorëve

Në nivel bashkie, rreth 53% e stokut të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2020 mbartet nga 8 bashki (paraqitur në grafikun 31). Niveli më i lartë i stokut të detyrimeve të prapambetura u regjistrua në bashkinë Tiranë me rreth 762 milionë lekë, ose 11% ndaj stokut total në fund të vitit 2020. Rreth 55% e këtyre detyrimeve janë për investime. Bashkia Kavajë renditet e dyta për nga niveli i

detyrimeve të prapambetura, me rreth 728 milionë lekë, ose rreth 10.5% ndaj totalit. E treta për peshën ndaj stokut të detyrimeve të prapambetura rezulton bashkia Vorë me rreth 703 milionë lekë apo rreth 10.1% e stokut total të detyrimeve në fund të vitit 2020, ndjekur nga bashkitë Pogradec (4.9%), Lezhë (4.4%), Roskovec (4.4%), Kamëz (3.8%), Vlorë (3.7%) etj.


Grafik 31. Peshë e bashkive në stokun e detyrimeve të prapambetura



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë & përpunime të autorëve


Në stokun e detyrimeve të detyrimeve totale) dhe vendimet prapambetura, peshën më të madhe gjyqësore (10%) ndjekur nga detyrimet e mbajnë detyrimet për investime për shërbime (10.3%) dhe të tjera (të cilat përfaqësuan rreth 54.4% (21.7%).

Grafik 32. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas kategorive



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë & përpunime të autorëve

Grafik 33. Detyrimet e prapambetura për frymë (në mijë lekë)



Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë & përpunime të autorëve

Ulja e detyrimeve të prapambetura dhe që do të duhet të shlyhen në periudhën afatmesme, rezulton të ketë ndodhur në 70.5% të bashkive (ose 43/61 bashki) dhe të jetë veçanërisht e ndjeshme në bashkitë: Tiranë (-996 milionë lekë), Kukës (-206 milionë lekë), Kamëz (-143 milionë lekë), Bulqizë (-122 milionë lekë), Dibër (-111 milionë lekë) etj. Në të kundërt, rreth 26.2% e bashkive (ose rreth 16/61 bashki) rezultojnë të kenë kontribuar në kahun rritës të stokut të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2020 krahasuar me nivelin e tij në fund të vitit 2019. Rritje e qenësishme e detyrimeve të prapambetura vihet re në bashkitë Vorë (+688 milionë lekë), Malësi e Madhe (+204 milionë lekë) dhe Roskovec (+157 milionë lekë).

Mesatarisht, detyrimet e prapambetura të bashkive rëndojnë qytetarët për rreth 2,475 lekë për frymë në fund të vitit 2020, nga rreth 2,9¹⁸ lekë për frymë në fund të vitit 2019. Në nivel bashkie, detyrimet e prapambetura për frymë shënojnë vlerën maksimale në bashkinë Vorë me rreth 27,542 lekë për frymë dhe nivelin minimal prej rreth 24 lekë për frymë në bashkinë Shkodër. Bashkitë Dropull, Patos, dhe Këlcyre rezultojnë të mos kenë detyrime të prapambetura në fund të vitit 2020 (shiko grafikun 33).

Për të vlerësuar rrezikun në terma të gradës së vështirësisë financiare nëpër të cilën kalojnë bashkitë varësisht borxheve dhe detyrimeve të papaguara do t'i referohemi parashikimeve të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Në nenin 57 pika 1 citohet:

"Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në vështirësi serioze financiare kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara."


Gjithashtu, në nenin 59 pika 1 citohet që:

"Njësia e vetëqeverisjes vendore konsiderohet në situatën e paaftësisë paguese nëse nuk arrin të zbatojë planin e rehabilitimit financiar dhe/ose nëse raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj shpenzimeve vjetore të miratuara është më i lartë sesa 1.3."

Bazuar nga sa parashikohet në kuadrin rregullator do të përdorim të dhënat mbi borxhin afatgjatë të bashkive, detyrimet e prapambetura dhe shpenzimet faktike të vitit 2020 për vlerësuar mbi vështirësitë financiare të bashkive dhe paaftësinë e tyre paguese (grafiku 34). Bazuar në sa ligji parashikon vlerësohet se bashkia Vorë ndodhet në gjendjen e paaftësisë paguese pasi raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve vjetore në vitin e fundit (shpenzimet faktike të bashkisë në vitin 2020) shënoi nivelin 2, 0.7 njësi mbi nivelin referencë. Në këto kushte, bashkia Vorë do të duhej të kalonte në procedurë për daljen nga gjendja e paaftësisë paguese, çka do të thotë se bazuar në MFE dhe KM e kalojnë këtë bashki nën administrim dhe me një plan të qartë për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Bashkia Kavajë ndodhet në situatën e vështirësive serioze financiare pasi, raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara ndaj shpenzimeve faktike të vitit 2020 kalon nivelin referencë prej 80% dhe shënon një nivel prej 102,4%. Bashkia e dytë në kushtet e vështirësisë serioze financiare është bashkia Roskovec me një vlerë të detyrimeve prej 81.5% të shpenzimeve faktike të vitit 2020. Për të dyja këto bashki MFE dhe KM duhet të marrin masat për të frenuar thellimin e mëtejshëm të vështirësive financiare. Ndërkohë, ndonëse nën prapambetura e parashikuar nga ligji, bashkitë Poliçan dhe Malësi e Madhe duhet të jenë shumë të kujdesshme në menaxhimin financiar pasi, raporti i detyrimeve ndaj shpenzimeve faktike për vitin 2020 kalon 50%.

Grafik 34. Vlerësim i paaftësisë paguese të bashkive




Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë & përpunime të autorëve

1.2 Të ardhurat nga taksat e ndara

Taksat e ndara midis qeverisë qendrore dhe vendore kanë qenë objekt debatesh të shumta në vitet e fundit. Me miratimin e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", u rishikuan dhe shtuan kategoritë e taksave të ndara ndërmjet qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Kështu, bashkitë përftojnë: (i) 97% e të ardhurave nga taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, persona fizikë dhe juridikë¹⁹; (ii) 25% të të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura; (iii) 5% të të

ardhurave nga renta minerare; dhe (iv) 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Ndër vite, ecuria e të ardhurave nga taksat e ndara paraqitet e luhatshme, në varësi të të ardhurës totale të mbledhur në nivel qendror. Në vitin 2020, të ardhurat nga taksat e ndara përfaqësuan rreth 9.4% ndaj të ardhurave nga burimet e veta vendore apo rreth 2.5% ndaj burimeve financiare totale. Në tërësi, të ardhurat nga taksat e ndara kontribuan në buxhetin vendor me rreth 2.3 miliardë lekë në fund të vitit 2020, në rritje me rreth 35.1% në terma vjetorë (grafiku 35).

Grafik 35. Ecuria e të ardhurave nga taksat e ndara

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Me ndryshimet e fundit legjislativë të aplikuara, ligji nr. 9975/2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar, u pezullua detyrimi për rentën minerare deri në vitin 2023 dhe e uli atë në 1/3 e normës për vitin 2024.²⁰ Ky ndryshim

i ndërmarrë nga qeveria qendrore pakëson në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhurat e bashkive, çka do të thotë që bashkitë do të duhet të kompensohen nëpërmjet një burimi tjetër të ardhurash (në mënyrë të ngjashme si

për të ardhurat e munguara nga tatimi i thjeshtuar mbi aktivitetin e biznesit të vogël). Gjithashtu, legjislacioni përkatës duhet harmonizuar pasi në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" në nenin 4, pika 4 citohet se taksat e ndara përdoren në autonomi nga bashkitë, ndërsa sipas ligjit nr. 9975/2008 "Për taksat kombëtare" citohet se bashkitë duhet ta përdorin të ardhurën nga renta minerare për investime.

Ndërkohë, situata mbi shpërndarjen e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale mbetet e paqartë si për vitin 2020 ashtu dhe me detyrimin e prapambetur për vitet e shkuara. Me një llogari të thjeshtë, kjo materializohet në një mungesë të ardhurash për buxhetet vendore që në terma kumulativë për të gjithë periudhën i vlerësohet në mbi 2 miliardë lekë,²¹ të cilat do të duhet të ndaheshin ndërmjet bashkive bazuar në parashikimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".


1.3 Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale

Transferta e pakushtëzuar (e përgjithshme dhe sektoriale) përbën një burim financiar thelbësor në përmbushje të funksioneve ekskluzive të bashkive, duke synuar mbylljen e hendekut negativ midis nevojës për shpenzime dhe kapacitetit fiskal.²² Ky burim financiar merr rëndësi të veçantë për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të bashkive në vijim të fatkeqësive natyrore me të cilat u përballën bashkitë duke filluar prej fundvitit 2019 dhe nën presionin e pandemisë së COVID-19. Ndonëse viti 2020 paraqiti vështirësi të shtuara si për buxhetin vendor ashtu dhe për atë qendror, niveli i transfertës së pakushtëzuar nuk pati rishikime dhe mbeti i pandryshuar në nivelin e parashikuar në buxhetin fillestar të qeverisë.²³

Në periudhën në analizë, të hyrat nga transfertat e pakushtëzuar (e përgjithshme dhe sektoriale për funksionet e reja) shënuan një nivel prej rreth 25.6 miliardë lekë, në rritje me rreth 3.6% në terma vjetorë (shiko grafikun 36). Në terma të rëndësisë relative, madhësia e transfertës së pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) është më e lartë se totali i të ardhurave nga burimet e veta vendore, përfaqëson rreth 49.1% e burimeve financiare të disponueshme për periudhën në analizë, dhe vlerësohet në rreth 1.6% të PBB-së nominale.

Rëndësia e këtij burimi bëhet më e dukshme në nivel bashkie, ku në rreth 91% të bashkive (ose 55 prej tyre) pesha e të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale rezultojnë

Grafik 36. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar ndër vite



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


mbi mesataren kombëtare të vitit 2020. Në bashkitë Fushë Arrëz dhe Memaliaj, mbi 90% e të hyrave në buxhet përfaqësohet nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale ndjekur nga bashkitë Këlcyrë (89.4%), Has (89%), Gramsh (87.5%), Libohovë (87.3%) etj. Në të kundërt, pesha minimale ndaj burimeve financiare të disponueshme u regjistrua në bashkinë Tiranë, me rreth 19.9% ndjekur nga bashkitë Himarë (34.4%), Sarandë (34.9%), Vorë (38.9%), Roskovec (42.1%), Patos (47.6%) të cilat qëndrojnë nën mesataren kombëtare

Transferta e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: (i) transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme e cila përdoret në autonomi të plotë nga bashkitë dhe ndahet bazuar në kriteret e formulës të miratuara në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"²⁴ dhe (ii) transfertat e pakushtëzuar sektoriale e cila sillet si transfertë me destinacion të përcaktuar


për funksionet e reja të transferuara në vitin 2006.

Duke filluar prej vitit 2017, niveli i transfertës së pakushtëzuar për bashkitë rezultojnë të ketë ndjekur prirje rritëse dhe parashikohet në rritje deri në vitin 2024. Megjithatë, në raundin e fundit të parashikimeve të MFE-së në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 duket që parashikimet të jenë ridimensionuar në kahun rënës. Bazuar në parashikimet në kuadër të PBA-së 2021-2023 transfertat e pakushtëzuar parashikohen të rriten me rreth 5% në vitin 2021 dhe me rreth 6% në terma vjetorë në vitet 2022 dhe 2023. Në vijim të situatës të krijuar nga tërmetet e fundit vitit 2019 dhe pandemia e COVID-19, parashikimet për rritjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë janë ulur disi duke parashikuar një rritje me rreth 1% në vitin 2021, nivel të pandryshuar për vitin 2022 dhe një rritje të saj me rreth 7% në vitet 2023 dhe 2024.

Grafik 37. Rëndësia e transfertës së pakushtëzuar në burimet e financimit të bashkive

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 38. Parashikimi i nivelit të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme


Burimi: MFE & Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Komponenti i dytë i transfertës së pakushtëzuar përbëhet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e cila shërben për mbulimin e shpenzimeve për kompetencat e transferuara nga qeveria qendrore tek bashkitë në vitin 2016.²⁵ Në vlerësimin e bashkive, transfertat sektoriale nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet e nevojshme për ofrimin me cilësi të funksioneve të transferuara, duke qenë se në momentin e transferimit të tyre, gjendja e përgjithshme e tyre ishte e dobët.

Në vitet 2019-2021 është shtuar një zë në transfertat e pakushtëzuara sektoriale për klubet shumësportëshe Partizani dhe Studenti me rreth 32 milionë lekë në vit. Krahas fondeve të parashikuara nga MFE-ja, bashkitë

mund të shtojnë fonde burimet e tyre për të ofruar një cilësi më të mirë të funksioneve të transferuara.²⁶ Që prej transferimit të tyre në bashki, transfertat sektoriale ka ndjekur një prirje lehtësisht në rritje ku krahas fondeve për mbulimin e shpenzimeve korrente të funksionit janë transferuar edhe fonde për investime: në vitin 2016 rreth 2.6 miliardë lekë fond për investime për ujitjen dhe kullimin; në vitin 2017 rreth 57 milionë lekë për sigurimin e digave dhe investime; në vitin 2018 rreth 50 milionë lekë për investime në funksionin e mbrojtjes nga zjarri; në vitin 2020 rreth 200 milionë lekë për investime në rrugë në bashkitë Gramsh dhe Rrogozhinë; dhe në vitin 2021 rreth 250 milionë lekë për investime në rrugë në bashkitë Finiq, Gramsh dhe Pogradec.²⁷

Grafik 39. Transferta e pakushtëzuar sektoriale



Burimi: MFE & Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Transferta sektoriale në funksionin e konvikteve të *arsimit parauniversitar* ndoqi prirje të lehtë rritëse gjatë periudhës 2016-2020 dhe pritet të jetë thuajse në të njëjtin nivel me vitin 2020 edhe përgjatë vitit 2021. Kjo transfertë përftohet nga 27 bashki dhe rreth 17.3% e fondeve totale i kalojnë bashkisë Tiranë, ndjekur nga bashkia Shkodër me rreth 11.1% të tyre.

Në funksionin e *arsimit parashkollor*, transferta sektoriale rezultojnë në rritje progresive në periudhën në analizë. Kjo transfertë mbulon shpenzimet për personelin mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor. Duke filluar prej vitit 2019, pjesa e transfertës sektoriale që shkon për mbulimin e shpenzimeve për personelin mësimor në arsimin parashkollor është ndarë me formulë. Pas një rritje me rreth 12.1% të shënuar në vitin 2018, norma e rritjes vjetore të fondeve në transfertën sektoriale

për këtë funksion është moderuar ndjeshëm në rreth 2.4% në vitin 2020. Për vitin 2021, transferta sektoriale parashikohet të rritet me rreth 0.8% në terma vjetorë (grafiku 40).

Nga transferta sektoriale në funksionin e arsimin parauniversitar përftojnë 57 bashki dhe fondet shkojnë për mbulimin e shpenzimeve për personelin jo-mësimor. Bashkitë Pustec, Konispol, Bulqizë dhe Finiq nuk marrin fonde për këtë funksion. Transferta sektoriale për arsimin parauniversitar shënoi një rritje të theksuar prej rreth 31.6% në terma vjetorë në vitin 2018 dhe më tej norma vjetore e rritjes rezultojnë të jetë moderuar ndjeshëm në rreth 1.1% në vitin 2020. Për vitin 2021, transferta sektoriale për kompetencat në arsimin parauniversitar parashikohet të shënojë rritje me rreth 3% në terma vjetorë (grafiku 40).

Për funksionin e *mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit*, transferta sektoriale shënoi rritje të theksuar dy-shifrore në vitin 2017 dhe 2018. Në vitin 2018, krahas fondeve të transfertës sektoriale për shpenzimet korrente të këtij funksioni, me kërkesë të Kuvendit janë akorduar dhe rreth 50 milionë lekë

shtesë për investime. Në vitet në vijim, fondet e transferuara për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme. Në vitin 2021, kjo transferta sektoriale për këtë funksion parashikohet të rritet me rreth 6.2% në terma vjetorë (grafiku 40).

Grafik 40. Transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas funksioneve (1)



Burimi: MFE & Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Transferta e pakushtëzuar sektoriale për *shërbimet sociale* mbulon shpenzimet për qendrat e shërbimeve sociale në bashkitë Kukës, Vau i Dejës, Fier, Kuçovë, Shkodër, Elbasan, Berat.²⁸ Pas një rritje vjetore me rreth 48% në vitin 2020, transferta sektoriale për këtë shërbim parashikohet të mbetet e pandryshuar gjatë vitit 2021 (grafiku 41).

Për funksionin e *administrimit të pyjeve* apo shërbimin pyjor niveli i transfertës sektoriale shënoi rritje të konsiderueshme në periudhën 2017-2018, vlerësuar si pasojë e zgjatjes në kohë e procesit të transferimit të funksionit dhe rakordimit ndër-institucional. Duke filluar nga viti 2019, norma vjetore e rritjes së transfertës sektoriale për këtë funksion rezultojnë të jetë moderuar dhe në vitin

Grafik 41. Transferta e pakushtëzuar sektoriale sipas funksioneve (2)



Burimi: MFE & Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2021 parashikohet të shënojë një rritje me rreth 10% në terma vjetorë (grafiku 41). Mesatarisht, transfertat sektoriale për administrimin e pyjeve mbulon rreth 166.7 lekë për hektar pyje (apo rreth 163,144 lekë për km² pyje) në vitin 2020.²⁹

Transferimi i kompetencave në funksionin e *rrugëve rurale* nga qarku në bashki u shoqërua me mjetet financiare për ushtrimin e këtij funksioni. Transferta sektoriale për rrugët rurale nuk ka pësuar ndryshime domethënëse gjatë periudhës 2016 – 2020. Për vitin 2020, kjo transfertë parashikohet të jetë rreth 521 milionë lekë, e njëjtë me nivelin e shënuar një vit më parë. Nga kjo transfertë nuk përfshihen bashkitë Kamëz, Rrogozhinë dhe Sarandë. Mesatarisht, transfertat

sektoriale për administrimin e rrugëve rurale mbulon rreth 44,952 lekë në vit për kilometër linear rrugë rurale në vitin 2020 (grafiku 41).³⁰

Ujitja dhe kullimi përfaqësojnë një funksion i cili efektisht është transferuar në vitin 2017 (për vitin 2016 nuk rezultoi të ketë patur një faturë financiare që të ketë shoqëruar këtë funksion). Ndër vite, fondet e transferuara për këtë funksion nuk kanë pësuar ndryshime të ndjeshme dhe për vitin 2021 parashikohet të shënojë një rritje me rreth 5.9% krahasuar me një vit më parë. Mesatarisht, transfertat sektoriale për ujitjen dhe kullimin mbulon rreth 23,339 lekë për km linear kanale në vit (apo rreth 1,945 lekë për km linear kanale në muaj) në vitin 2020).³¹

Nën presionin e krijuar nga tërmetet e vitit 2019, pandemia e COVID-19, situata e përmytjeve të vazhdueshme në periudhën e dimrit MFE parashikon për bashkitë një fond prej rreth 500 milionë lekë për vitin 2021. Ky fond vjen si transfertë specifike për "Mbrojtjen Civile" në trajtën e një transfertë specifike e cila duhet të përdoret

vetëm për rastet e emergjencave civile dhe do të jetë i trashëgueshëm (me destinacion të njëjtë në vitin pasardhës në rast mos përdorimi të tij).³² Shpërndarja e këtij fondi ndërmjet bashkive kryhet duke u bazuar në peshën relative të bashkive në buxhetin total të 61 bashkive.

1.4 Transfertat e kushtëzuara

Transfertat e kushtëzuara përfaqësojnë një burim financiar për të mundur ushtrimin e funksioneve të deleguara dhe për projekte të veçanta (të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar) ku kërkohet bashkëpunimi i njësive vendore, bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Nisur nga sa specifikohet në ligj, fondet e kushtëzuara të transferuara në bashki përfshijnë jo vetëm fondet për ushtrimin e funksioneve të deleguara, por në to mund të kanalizohen edhe fondet për investime (përfshirë këtu dhe FZHR).

Pesha e transfertave të kushtëzuara ndër vite ka qenë e luhatshme dhe përfaqësoi mesatarisht 50% të burimeve financiare totale gjatë periudhës 2010-2015. Në periudhën në vijim, 2016-2020, mesatarisht të hyrat nga transfertat e kushtëzuar u tkurrën dhe përfaqësuan rreth 40% të burimeve financiare totale të bashkive. Ndonëse nuk ushtrojnë kontroll mbi destinacionin e tyre, të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara përfaqësuan rreth 42.8% ndaj totalit të burimeve financiare të bashkive në vitin 2020, vlerë kjo rreth 6 pikë përqindje më e lartë krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit

2020, qeverisja qendrore u transferoi bashkive rreth 38.9 miliardë lekë në trajtën e transfertës së kushtëzuar, rreth 31.6% më shumë krahasuar me një vit më parë.


Në vitin 2020, fondet e transferuara nga ministria përgjegjëse për *mirëqenien sociale*³³ shënuan një nivel prej rreth 24.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 17.5% krahasuar me vitin e mëparshëm. Kjo rritje vjen si pasojë e dyfishimit të pagesave për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë, vendim i cili pritët të shtrijë efektet deri në mesin e vitit 2021.³⁴ Këto fonde u transferohen bashkive në trajtën e transfertës së kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë, dhe më tej bashkitë bëjnë shpërndarjen e tyre në përfituesit fundorë.

Gjatë vitit 2020, evidentohet një rritje e qenësishme e fondeve të kanalizuar në nivel vendor nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për *transportin dhe infrastrukturën* e cila transferoi rreth 7.6 miliardë lekë nga rreth 2.8 miliardë një vit më parë. Entitetet qendrore përgjegjëse për *zhvillimin urban* transferuan rreth 609 milionë lekë në nivel bashkie (-60% krahasuar

me vitin e mëparshëm), të cilat janë shpenzuar më së shumti në përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe zhvillimit të komunitetit. Ministria përgjegjëse për

arsimin, sportin dhe rininë shpenzoi në nivel vendor rreth 1.3 miliardë lekë në vitin 2020, në rënie me rreth 53.7% krahasuar me një vit më parë,

Grafik 42. Transfertat e kushtëzuara sipas funksioneve




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

1.5 Burimet financiare: sa dhe nga buruan paratë në dispozicion të bashkive në vitin 2020?

Ky seksion synon të pasqyrojë nga burojnë fondet / paratë me të cilat bashkitë ushtrojnë funksionet dhe përgjegjësitë, ofrojnë shërbime për komunitetin dhe zhvillimet e tyre në fund të vitit 2020.³⁵ Burimet financiare totale në dispozicion të bashkive për vitin 2020 regjistruan një vlerë prej 90.9 miliardë lekë, në rritje me rreth 11.6% krahasuar me një vit më parë.³⁶

Nëse nga totali i burimeve financiare do të përjashtonim ato kategori të konsideruara me destinacion (transferat të kushtëzuara), të ardhurat mbi të cilat bashkitë ushtrojnë autoritet dhe kanë të drejta vendimmarrjeje shënuan një vlerë prej rreth 52 miliardë lekë, në rritje me rreth 0.2% në terma vjetorë.

Grafik 43. Ecuria e burimeve financiare totale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Tabelë 6. Burime financiare sipas kategorive

	Të ardhura nga burime të veta	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Taksa të ndara	Transferta të kushtëzuara	Të trashëguara	Burime financiare totale	Burime financiare totale (përfshirë të trashëguara)
në miliardë lekë							
2010	12.9	10.6	1.2	25.8	5.2	50.4	55.7
2011	12.6	10.2	1.3	23.4	3.6	47.6	51.1
2012	12.0	9.2	1.4	22.7	3.8	45.4	49.1
2013	12.2	11.0	1.5	25.2	4.2	49.8	54.0
2014	14.4	12.1	1.1	28.6	4.6	56.2	60.8
2015	13.1	11.3	1.1	26.4	8.3	51.8	60.1
2016	16.8	18.1	1.0	25.6	7.8	61.6	69.4
2017	20.3	21.9	1.2	32.3	5.1	75.8	80.8
2018	24.2	23.6	1.5	33.9	1.5	83.1	84.6
2019	25.6	24.7	1.7	29.6	4.3	81.5	85.8
2020	24.2	25.6	2.3	38.9	0.5	90.9	91.5

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Burimet financiare mbi të cilat bashkitë kanë liri relative përdorimi në fund të vitit 2020 përfaqësuan rreth 57.2% të burimeve financiare totale dhe përfshijnë: të ardhurat nga burimet e veta (26.6%), të ardhura nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale³⁷ (28.1%) dhe të ardhurat nga taksa të ndara (2.5%). Transfertat e kushtëzuara rritën me rreth 6.5 pikë përqindje peshën e tyre në totalin e burimeve financiare të bashkive në fund të vitit 2020.


Në vitin 2020, kahu i zhvillimeve në ecurinë e burimeve financiare të bashkive u përcaktua gjerësisht

prej zgjerimi të shënuar në të hyrat nga transfertat e kushtëzuara të cilat kontribuan me rreth 11.5 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të burimeve financiare. Ky zë vlerësohet do të ndikojë pozitivisht në rritjen e burimeve financiare të bashkive edhe përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021 (rritja e pagesës së ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë). Në të njëjtin drejtim, edhe pse në masë më të vogël (1.1 pikë përqindje), kontribuan edhe të hyrat nga transferta e pakushtëzuar dhe ajo sektoriale. Kontributi i të hyrave nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike për vitin

2021 pritet të jetë i ngjashëm me atë të vitit 2020, sipas udhëzimit për PBA-në 2021-2023. Në të kundërt, zhvillimet në kahun rënës në të ardhurat nga burimet e veta vendore kontribuan negativisht në ecurinë e përgjithshme të burimeve financiare totale në vitin 2020. Për vitin 2021, kjo kategori të ardhurash paraqet paqartësi më të larta krahasuar me kategoritë e tjera (transfertat ndërqeveritare), nisur

nga lehtësitë që një pjesë e bashkive kanë ndërmarrë si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, zhvendosjes në kohë të pagesave të detyrimeve vendore apo dhe faljes së tyre. Situata parazgjedhore (për zgjedhjet e përgjithshme të 25 Prillit) vështirëson vlerësimet mbi zhvillimet e mundshme në financat vendore të bashkive veçanërisht përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021.

Grafik 44. Kontributi i kategorive (në pikë përqindje) në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në përqindje)




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Pavarësisht burimit të financimit, për vitin 2020 bashkitë patën në dispozicion rreth 32,477 lekë për frymë, në rritje me rreth 11.6% krahasuar me një vit më parë (shiko aneksin 6). Duke i kthyer të dhënat mbi të ardhurat për frymë në indeks me bazë 100, mund të evidentojmë pozicionimin bashkive përkundrejt mesatares së 61 bashkive

(të cilën e quajmë 100). Niveli më i ulët i të ardhurës për frymë prej rreth 19,684 lekë u shënuar në bashkinë Kamëz (ndër bashkitë me dendësinë më të lartë të popullsisë) dhe niveli maksimal i burimeve financiare për frymë u shënuar në bashkinë Dropull (e cila renditet ndër bashkitë me popullsinë më të ulët). Rreth 46% e bashkive (apo

28/61) shënojnë një nivel të indeksit nën mesataren kombëtare.

Në terma mesatarë, sipas origjinës së burimeve të financimit rreth 8,640 lekë gjenerohen nga bashkitë nga të ardhurat nga burimet e veta vendore; rreth 9,936 lekë nga transfertat e pakushtëzuara (e përgjithshme, sektoriale, taksa të ndara) dhe rreth 13,900 lekë nga transfertat e kushtëzuara (për më shumë shiko anekset 4 dhe 5).



2 SI I PËRDORËN BASHKITË PARATË NË DISPOZICION?

Modeli i decentralizimit simetrik i zbatuar në Shqipëri i bën 61 bashkitë në vend njëloj përgjegjëse për ushtrimin e mbi 41 funksioneve dhe kompetencave në fusha si: infrastruktura dhe shërbimet publike; shërbimet sociale; shërbimet kulturore, sportive dhe argëtuese; shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit; bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat publike, natyra dhe biodiversiteti; zhvillimi ekonomik vendor; siguria publike (për më shumë detaje shiko aneksin 2). Krahas tyre, 61 bashkitë në vend ushtrorë gjithashtu funksione të deleguara, funksione të cilat qeverisja vendore i delegon për zbatim në nivel vendor si gjendja civile, ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë. Për këto funksione, qeveria qendrore u transferon bashkive ato që emërtohen si transfertë të kushtëzuara, para të cilat duhet të përdoren për shërbimin për të cilin ato janë transferuar (quajtur ndryshe fonde me destinacion të përcaktuar). Të gjitha këto funksione, bazuar në parimin e subsidiaritetit, i janë besuar bashkive në mënyrë të njëtrajtshme, pra secila prej 61 bashkive në vend ka detyrimin ligjor t'i ofrojë për komunitetin në territorin e saj. Në kuadrin e thellimit të decentralizimit të qeverisjes vendore, ndër 41 funksionet e ushtruara nga bashkitë, 7 prej tyre ishin subjekt

transferimi nga qeveria qendrore tek bashkitë në vitin 2016.³⁸

Në vlerësimin dhe reagimet e bashkive, fatura financiare që shoqëroi transferimin e këtyre funksioneve ishte e pamjaftueshme për ushtrimin e tyre duke ushtruar presione të shtuara në buxhetin vendor.


Rëndësia e qeverisjes vendore në terma të shpenzimeve rezulton të jetë rritur duke filluar prej vitit 2015, matur nga treguesit për shpenzimet (totale dhe me fonde të veta) ndaj PBB-së nominale dhe shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme. Treguesi i shpenzimeve të kryera me fonde të veta ndaj PBB-së shënoi rritje nga rreth 2.3% në vitin 2015 në rreth 3.3% në fund të vitit 2019 (shiko grafikun 45). Në vitin 2020, ky tregues vlerësohet të ketë shënuar nivelin 3.2%, në rënie me rreth 0.1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (grafiku 45). Treguesi i shpenzimeve me fonde të veta ndaj PBB-së qëndron ndjeshëm nën mesataren e vendeve të BP (mesatarja 5.5%), vendeve të EJT-së (mesatarja 6%), vendeve të EU28 (mesatarja 10.6%) dhe vendeve të OECD-së (mesatarja 15.5%).³⁹

Nëse do të merrnim në analizë treguesin për shpenzimet totale të

kryera nga qeverisja vendore (duke përfshirë shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara), treguesi i shpenzimeve totale ndaj PBB-së nominale rezulton të jetë rritur nga rreth 4.1% në vitin 2015 në rreth 5.1% në vitin 2019. Në vitin 2020, ky tregues shënoi rritje me rreth 0.6 pikë

përqindje në vijim të intensifikimit të shpenzimeve me fonde të kushtëzuara për pagesën e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë (fonde të transferuara nga qeverisja qendrore dhe që patën dy-fishim për shkak të pandemisë së COVID-19).

Grafik 45. Tregues të shpenzimeve ndaj PBB-së



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Treguesit e shpenzimeve (me fonde të veta dhe totale) në raport me shpenzimet e qeverisjes së përgjithshme, janë rritur krahasuar me vitin 2015 (shiko grafikun 46). Me shtimin e funksioneve të bashkive dhe rritjen e nivelit të transfertave ndërqeveritare të pakushtëzuara, treguesi i shpenzimeve me fonde të veta ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme u rrit në nivelin 11.4% në fund të vitit 2019 nga rreth 7.5% në vitin 2015. Në të kundërt,

në vitin 2020, ky tregues shënoi nivelin prej rreth 9.6%, në rënie me rreth 1.8 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019. Treguesi i shpenzimeve me fonde të veta ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme qëndron ndjeshëm nën mesataren e vendeve të BP (mesatarja 15.5%), vendeve të EJT-së (mesatarja 16.6%), vendeve të EU28 (mesatarja 23.3%) dhe vendeve të OECD-së (mesatarja 40.4%).⁴⁰

Një prirje e ngjashme vërehet edhe kur konsiderojmë treguesin e shpenzimeve totale ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme i cili shënoi nivelin 16.8%, në rënie me rreth 0.5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Ecuria e treguesve të shpenzimeve ndaj PBB-së dhe ndaj shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme tregon për

prirje rritëse të tyre ndër vite, ndonëse kjo rritje është diktuar gjerësisht prej ecures së transfertave ndërqeveritare. Krahas varësisë së krijuar nga kjo kategori fondesh, një element dobësie paraqitet nga luhatshmëria dhe ndjeshmëria e treguesve të konsideruar ndaj goditjeve, ashtu si dhe viti i fundit tregoi.

Grafik 46. Tregues të shpenzimeve ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë


Përdorimi i parave në dispozicion të bashkive është një aspekt thelbësor për zhvillimin afatgjatë në përgjithësi dhe atë vendor në veçanti. Vizioni afatgjatë i zhvillimit, objektivat strategjikë dhe investimet parësore janë të përcaktuara në dokumentet e planeve të përgjithshme vendore të bashkive (PPV-ve, strategjia për zhvillimin e territorit dhe plani i investimeve kapitale) dhe teorikisht zbatohen nëpërmjet përfshirjes së tyre në planet buxhetore afatmesme

(PBA) dhe buxhetet vjetore. Nisur nga numri i lartë i shërbimeve publike për t'u administruar, duket se vëmendja e bashkive është më shumë e zhvendosur në mbulimin e shpenzimeve korrente për ofrimin e tyre. Ndonëse në pesë vitet e fundit fondet për investime nga qeveria qendrore (në trajtën e fondeve të kushtëzuara, përfshirë fondet nga FZHR) kanë mbuluar deri diku nevojën për investime në territoret e bashkive, por niveli i tyre mbetet ende i ulët.

Shpenzimet kapitale totale të kryera nga qeveria e përgjithshme përfaqësuan rreth 5.4% të PBB-së në vitin 2020, rreth 1 pikë përqindje më shumë se një vit më parë si pasojë e shpenzimeve të shtuara për ri-ndërtimin pas tërmetit (shiko grafikun 47). Në nivel vendor, shpenzimet kapitale të kryera me fonde të veta në vitin 2020 përfaqësuan rreth 0.8% ndaj PBB-së nominale, raport ky në rënie me rreth 0.2 pikë përqindjeje

krahasuar me vitin e mëparshëm (dhe më i ulët se ai në vitin 2010). Nëse do të konsideronim edhe investimet e kryera me fonde të kushtëzuara (fonde të transferuara nga qeveria qendrore për projekte investimesh), treguesi i investimeve ndaj PBB-së për vitin 2020 vlerësohet në rreth 1.4%, në rënie me rreth 0.1 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Grafik 47. Tregues të investimeve ndaj PBB-së




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Presionet e shtuara në buxhetet vendore gjatë vitit 2020 duket të kenë zhvendosur gërshërën në investimet me fonde të veta të cilat përfaqësuan rreth 14.8% të investimeve publike në vitin 2020, në rënie me rreth 8.6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019 (shiko grafikun 48). Në mënyrë të ngjashme, treguesi i investimeve totale të kryera

nga bashkitë ndaj investimeve publike për vitin 2020 shënoi nivelin 25.7%, në rënie me rreth 7.4 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Ky tregues qëndron nën mesataren e vendeve të Ballkanit Perëndimor (rreth 28.4%), vendeve të Evropës Jug-Lindore (rreth 39.8%), vendeve të BE-së (rreth 45%) dhe OECD-së (rreth 56.9%).⁴¹

Grafik 48. Tregues të investimeve ndaj investimeve publike



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Shpërndarja e shpenzimeve të kryera nga qeveria qendrore dhe vendore sipas funksioneve, tregon sesi qeverisja vendore dhe ajo qendrore ndajnë mes tyre ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave (matur nga përqindja e shpenzimeve të kryera nga secili nivel i qeverisjes bazuar në klasifikimin COFOG).

Në vitin 2020, shpenzimet e kryera nga 61 bashkitë në vend përfaqësuan rreth 9.6% të shpenzimeve totale të kryera nga qeverisja e përgjithshme, rreth 1.8 pikë përqindje më pak krahasuar me një vit më parë. Diferenca prej rreth 90.4% e shpenzimeve totale u krye nga qeveria e përgjithshme. Ky tregues, krahas treguesve të tjerë të lartpërmendur përforcon gjetjet për një qeverisje vendore (bashkitë) me peshë të vogël

dhe me mjete financiare në dispozicion që luhaten vit pas viti varësisht vendimeve të qeverisë qendrore.


Në grafikun 49, paraqitet pesha relative qeverisjes vendore dhe qendrore në shpenzimet e përgjithshme sipas funksioneve (klasifikimi COFOG). Duke përjashtuar mbrojtjen, si një funksion i ushtruar ekskluzivisht në nivel qendror, bashkitë duket të kenë nivelin më të lartë të shpenzimeve në raport me qeverinë qendrore në funksionin "mbrojtja e mjedisit", ku në vitin 2020 shpenzimet e të cilave përfaqësuan rreth 74.7% të shpenzimeve totale të kryera nga qeverisja e përgjithshme për këtë funksion. Funksioni i dytë ku bashkitë zënë përqindje të konsiderueshme është "argëtimi, kultura dhe çështjet fetare" me rreth 34.3% të shpenzimeve totale të kryera nga

qeveria e përgjithshme. Në të kundërt, bashkitë kanë rol dhe peshë të ulët dhe të papërfillshme në dy shërbime të rëndësishme për komunitetin: shëndetësi dhe mbrojtje sociale me përkatësisht 0.1% dhe 0.8% të shpenzimeve totale të kryera nga qeveria e përgjithshme. Roli i marxhinal i bashkive në këtë drejtim u duk qartazi në vijim të dy fatkeqësive të mëdha që goditën vendin në mënyrë të

njëpasnjëshme në fund të vitit 2019 dhe situatës së pandemisë COVID-19.

Në të dyja rastet, pavarësisht përpjekjeve për të mbështetur me sa mundur komunitetin dhe shtresat në nevojë, situata u administrua në mënyrë të qendëruar nga qeveria qendrore me përfshirjen sipërfaqësore të bashkive.

Grafik 49. Shpenzimet vendore dhe qendrore sipas funksioneve



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & Ministria e Financave dhe Ekonomisë

2.1 Shpenzimet sipas burimit të financimit

Në këtë seksion do të paraqitet një panoramë të përgjithshme mbi mënyrën si janë shpenzuar paratë në dispozicion të bashkive në vitin 2020: sipas burimit të financimit dhe kryqëzuar me kategorizimin sipas natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe sipas funksioneve të qeverisjes (arsim, çështje ekonomike, mbrojtje mjedisi, etj.).


Në fund të vitit 2020, mjetet financiare të kanalizuar nga 61 bashkitë në vend, regjistruan një vlerë prej rreth 90.2 miliardë lekë, shifër kjo rreth 5.6% më e lartë se ajo e regjistruar në vitin e mëparshëm. Përjashtuar shpenzimet e kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm (me destinacion apo jo), rezulton se bashkitë kanë shpenzuar në vitin 2020 rreth 89.7 miliardë lekë, rreth 10.5% më shumë se një vit më parë.

Shpenzimet me fondet e veta të bashkive regjistruan një nivel prej rreth 51.3 miliardë lekë në fund të vitit 2020, duke shënuar rënie me rreth 8.1% krahasuar me vitin e mëparshëm. Shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara shënuan një vlerë prej rreth 38.9 miliardë lekë, në rritje të theksuar me rreth 9.3 miliardë lekë apo me rreth 31.6% në terma vjetorë. Në terma strukturorë, rreth 56.9% e shpenzimeve totale u krye me fonde nga burime të veta, ndërsa 43.1% e

tyre me fonde të kushtëzuara. Kjo zhvendosje e peshës në favor të shpenzimeve me fonde të kushtëzuara tregon për një "jastëk" artificial të krijuar nga qeveria qendrore për të mbyllur nevojën për shpenzime të bashkive, në kushtet e fatkeqësive natyrore apo presioneve në vijim të goditjeve të jashtme dhe/ose të brendshme. Kjo lloj mbështetje sjell në vëmendje rëndësinë e forcimit të bashkive në terma financiarë (autonominë e tyre) si dhe qartësimin e kompetencave ndërmjet dy niveleve të qeverisjes (për funksionet e ushtruara).


Mesatarisht në tre vitet e fundit shpenzimet korrente janë mbuluar në masën 60% me fonde nga burimet e veta vendore dhe për rreth 40% nga burimet financiare të kushtëzuara (shiko grafikun 51). Në fund të vitit 2020, shpenzimet korrente u mbuluan në masën 56.6% nga burimet financiare vendore dhe për rreth 43.4% nga ato të kushtëzuara (përfshirë këtu fondet nga FZHR). Ndërkohë, mesatarisht në tre vitet e fundit shpenzimet kapitale u mbuluan mesatarisht në masën 62% nga burimet e veta vendore dhe në masën 38% nga burimet e kushtëzuara. Në fund të vitit 2020, shpenzimet kapitale u mbuluan në masën 57.7% nga burimet financiare vendore dhe për rreth 42.3% nga ato të kushtëzuara (përfshirë këtu fondet nga FZHR).

Grafik 50. Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 51. Mbulimi i shpenzimeve sipas burimit




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Kryqëzimi i të dhënave të shpenzimeve sipas burimit të financimit dhe klasifikimit funksional tregon se, funksioni "mbrojtja sociale" mbulohet gjerësisht me fonde të kushtëzuara (transferta e kushtëzuar nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale). Në vitin 2020, rreth 95% e shpenzimeve për funksionin e mbrojtjes sociale u financua me transferta të kushtëzuara (transferta në buxhetet familjare për pagesë papunësie dhe PAK), nivel ky më i larti që prej vitit 2016. Në të kundërt, bashkitë mbulojnë me

fonde të veta shpenzimet e kryera në funksionet "rendi dhe siguria publike", "mbrojtja e mjedisit", "argëtimi, kultura dhe çështjet fetare" dhe "shëndetësia", shpenzimet e të cilëve zënë më pak se 10% të shpenzimeve totale të kryera nga bashkitë. Në funksionin "shërbimet e përgjithshme publike" bashkitë mbulojnë me fonde të veta rreth 96% të shpenzimeve. Në funksionin e "çështjeve ekonomike", në vitin 2020 rreth 90% e shpenzimeve u mbulua me fonde të veta dhe 10% me fonde të kushtëzuara. Në funksionin e "strehimit

Grafik 52. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional dhe burimit të financimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

dhe komoditeteve të komunitetit", dy nivelet e qeverisjes kanë rol thuajse të njëjtë në terma të shpenzimeve, raport ky që lëviz nga viti në vit. Në vitin 2020, rreth 46% e shpenzimeve në këtë funksion u mbulua me fonde të veta të bashkive dhe rreth 54% me fonde të kushtëzuara nga qeveria qendrore


(kryesisht fonde për investime). Arsimi është një funksion shpenzimet për të cilin tregojnë për një rritje të rolit të bashkive në financimin e tyre. Për vitin 2020, rreth 74% e shpenzimeve në këtë funksion u mbulua me fonde të veta të bashkive dhe diferenca me fonde të kushtëzuara (grafiku 52).

2.2 Shpenzimet e kryera me fonde të veta të bashkive

Pas një rritje me ritme dy-shifrore në vitin 2019, shpenzimet e kryera me fonde të veta të 61 bashkive regjistruan një nivel prej rreth 51.3 miliardë lekë në vitin 2020,⁴² në rënie me rreth 8.1% krahasuar me vitin e mëparshëm.⁴³ Në 10 vitet e fundit, shpenzimet me fonde të veta kanë ndjekur prirje rritëse dhe viti 2020 shënon frenimin e parë të tyre


prej vitit 2012. Përfunduar shpenzimet e kryera nga bashkia Tiranë (rreth 35.7% e shpenzimeve totale të kryera me fonde të veta), shpenzimet me fonde të veta shënuan tkurrje me rreth 9.2% në terma vjetorë. Ndër to, rreth 525.6 milionë lekë janë shpenzime të kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm.

Grafik 53. Ecuria e shpenzimeve me fonde të veta të bashkive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 54. Shpenzimet me fondet të veta sipas bashkive

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet me fonde të veta rezultojnë të jenë tkurrur në rreth 62% apo 38/61 bashki (grafiku 54). Rënia e shpenzimeve me fonde të veta vlerësohet të ketë ndodhur në të gjitha kategoritë e bashkive, si të voglat ashtu dhe ato të mëdha. Tkurrja e shpenzimeve shënoi nivelin maksimal në bashkinë Mallakastër me rreth 44.7% në terma vjetorë, ndjekur nga bashkitë Vorë (me rreth -44.4%), Vau i Dejës (me rreth -37.5%), Lezhë (me rreth -26.8%), Kamëz (me rreth -22.6%), Shkodër dhe Durrës (me rreth -15.8% respektivisht), Tiranë (me rreth -6.2%) etj.

Në të kundërt, shpenzimet me fonde të veta vlerësohet të jenë zgjeruar në terma vjetorë në 38% të bashkive (23/61 bashki). Bashkia Rrogozhinë shënoi rritjen më të lartë të shpenzimeve me fonde të veta prej rreth 47.6%, ndjekur nga bashkitë Prrenjas (me rreth +27.8%), Skrapar (me rreth +27.8%), Belsh (me rreth +23.5%), Fushë Arrëz (me rreth +15.2%) etj.


Në vijim, informacionet në lidhje me shpenzimet e kryera me fonde të veta do të analizohen në detaje sipas klasifikimit ekonomik dhe funksional të tyre.

2.2.1 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit ekonomik


Bazuar në klasifikimin sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve të kryera me fonde të veta, në vitin 2020 bashkitë përdorën rreth 75.4% të fondeve të tyre për mbulimin e shpenzimeve korrente (rreth 38.7 miliardë lekë) dhe rreth 24.6% në mbulimin e shpenzimeve kapitale (rreth 12.6 miliardë lekë). Kahu i zhvillimeve në shpenzimet me fonde të veta në vitin 2020 u përcaktua nga ecuria e shpenzimeve kapitale, të cilat shënuan rënie të ndjeshme vjetore.

Ndër kategoritë e shpenzimeve korrente, shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime) përbënë rreth 22.2 miliardë lekë gjatë periudhës së konsideruar, në rritje me rreth 2.6% krahasuar me vitin 2019. Shpenzimet për personelin ndoqën prirje rritëse vjetore, ndonëse me ritme më të moderuara ndikuar dhe nga shuarja e efektit të rritjes së numrit të punonjësve si pasojë e transferimit të funksioneve të reja në vitin 2016.⁴⁴ Kështu, në vijim të rritjes me rreth 53.4% në vitin 2016 (në vijim të transferimit të funksioneve të reja), norma e rritjes u moderua në mënyrë progresive në 5.4% në vitin 2019 dhe në rreth 2.6% në vitin në analizë.

Grafik 55. Struktura e shpenzimeve me fonde të veta

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Grafik 56. Shpenzimet me fonde të veta sipas natyrës ekonomike

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

*Shpenzimet operative dhe të tjera*⁴⁵ regjistruan një nivel prej rreth 16.5 miliardë lekë në fund të vitit 2020, në rënie me rreth 0.8% krahasuar me një vit më parë. Në nivel të detajuar, shpenzimet operative të kryera me fonde të veta për këtë periudhë shënuan një vlerë prej rreth 15.2 miliardë lekë, në rritje me rreth 2.4% në terma vjetorë. Thua se të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative rezultojnë të jenë zgjeruar gjatë vitit 2020: shpenzimet për materiale zyre (+22%); shërbime nga të tretë (+3.2%); shpenzime transporti (+3%); shpenzime të tjera operative (+0.2%); dhe mirëmbajtje e zakonshme

(+1.5%). Në të kundërt, shpenzimet për udhëtime shënuan rënie me rreth 52% në terma vjetorë, si pasojë e kufizimeve në lëvizje nga pandemia e COVID-19. Duke filluar prej vitit 2015, ecuria e shpenzimeve operative qartësisht po ndjek një trajektore rritëse vit pas viti, ku fundi i vitit 2020 shënoi nivelin maksimal të tyre. Ndonëse, rritja e shpenzimeve në këtë kategori rezulton të jetë e shpërndarë në thujtë të gjithë nënëzërë përbërës dhe bashkitë, ecuria e tyre në terma afatmesëm dhe afatgjatë duhet monitoruar me kujdes pasi mund të krijojë probleme qëndrueshmërie financiare për bashkitë.

Grafik 57. Shpenzimet operative sipas zërave

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet për *transferta* për buxhetet familjare dhe individët gjithashtu janë një zë i rëndësishëm në totalin e shpenzimeve me fonde të veta të bashkive. Për vitin 2020, kjo kategori shpenzimesh shënoi një vlerë prej rreth 933.2 milionë lekë, në rënie me rreth 33.1% në terma vjetorë.

Ndonëse një vit i vështirë, veçanërisht për shtresat në nevojë, një pjesë e madhe e bashkive kanë ulur mbështetjen e tyre për këtë kategori të popullatës (duke u mbështetur tek fondet e transferuara nga qeveria qendrore për këtë qëllim).


Niveli i transfertave rezulton të ketë shënuar rënien më të madhe në bashkinë Tiranë me rreth 468.1 milionë lekë apo rreth 73% krahasuar me vitin 2019. Në të njëjtin drejtim transfertat rezultojnë në tkurrje në 35/61 bashki, dhe veçanërisht në bashkitë: Vorë (-30.3 milionë lekë ose -68% në terma vjetorë), Vlorë (-7.9 milionë lekë ose -58% në terma vjetorë), Mat (-6.6 milionë lekë ose -26% në terma vjetorë), Peqin (-5.6 milionë lekë ose -49% në terma vjetorë) etj. Në të kundërt, shpenzimet për transfertat nga fondet e veta të bashkive janë rritur në bashkitë Pogradec (+22.2 milionë lekë), Dibër (+11.6 milionë lekë), Bulqizë (+11.6 milionë lekë), Fier (+8.6 milionë lekë), Përmet (+6.4 milionë lekë) etj.

Pagesat për interesa shënuan një vlerë prej rreth 201.7 milionë lekë në vitin 2020, në rritje me rreth 5.9% në terma vjetorë dhe përfaqësojnë rreth 0.4% të shpenzimeve totale me fonde të veta. Pagesat për interesa kryhen nga bashkitë të cilat kanë kredi aktive në sistemin bankar vendas si bashkitë Elbasan, Korçë, Lezhë, Vlorë (për më tepër shiko seksionin 2.1.3 mbi huamarrjen vendore dhe detyrimet e prapambetura).


Shpenzimet kapitale ose investimet, përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxheteve vendore dhe një parakusht për zhvillim ekonomik afatgjatë. Ndër vite, niveli i shpenzimeve kapitale ka qenë i luhatshëm dhe paraqet një korrelacion të mirë me ecurinë e burimeve financiare të veta të bashkisë, veçanërisht me të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Pas rritjes së konsiderueshme të vërejtur në vitin 2019 (+34.7% në terma vjetorë), shpenzimet për investime në vitin 2020 shënuan një nivel prej rreth 12.6 miliardë lekë, në rënie me rreth 28.3% krahasuar me një vit më parë. Niveli i investimeve në fund të viti 2020 shënon vlerën më të ulët të regjistruar që pas RAT (duke përfaqësuar rreth 24.6% të shpenzimeve totale me fonde të veta) dhe është thajse i barabartë me nivelin e shënuar në vitin 2015.

Grafik 58. Transfertat sipas bashkive (diferenca me vitin 2019)



Grafik 59. Prirja e shpenzimeve kapitale me fonde të veta




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ardhurat nga TNI duhet të përdoren "kryesisht" për financimin e investimeve. Ndonëse në prani të një parashikimi të tillë, nuk është e mundur gjurmueshmëria nga burimi i të ardhurës deri në përdorimin e saj. Megjithatë, është e mundur të analizojmë nivelin e mbulimit të shpenzimeve kapitale të kryera me fonde të veta të bashkive nga të ardhurat e gjeneruara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Mesatarisht për 61 bashkitë në vend, të ardhurat nga TNI mbulojnë rreth 62.8% të shpenzimeve kapitale të kryera me fonde të veta, raport ky në rritje me

rreth 14.9 pikë përqindje krahasuar me nivelin e regjistruar në vitin 2019 (prej rreth 47.9%). Nëse do të përjashtonim bashkinë Tiranë, mesatarisht në 60 bashkitë e tjera të ardhurat nga TNI arrijnë të mbulojnë vetëm 24.7% të shpenzimeve kapitale të kryera me fonde të veta në vitin 2020. Në të kundërt, në vitin 2020 të ardhurat nga TNI mbuluan plotësisht shpenzimet kapitale me fonde të veta të bashkisë Tiranë. Në mënyrë të tërthortë, ky tregues edhe një herë nënvizon përqendrimin e presioneve zhvillimore në bashkinë Tiranë dhe pamundësinë e bashkive të tjera për të financuar projekte investimesh (veçanërisht ato me vlerë të lartë).

Grafik 60. Financimi i shpenzimeve kapitale nga TNI




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të dhënat në nivel bashkie të paraqitura në grafikun 61 pasqyrojnë më qartë situatën dhe diferencën që ekziston ndërmjet tyre për mundësinë e financimit të shpenzimeve kapitale. Në 3/61 bashki, TNI arrin të mbulojë tërësisht shpenzimet kapitale me fonde të veta (dhe ti tejkalojë ato): në bashkinë Tiranë (100%), në bashkinë Vlorë (118.4%) dhe në bashkinë Himarë (132.3%). Në bashkinë Vorë të ardhurat nga TNI mbuluan rreth 90.7% të shpenzimeve kapitale me fonde të veta dhe në bashkinë Tepelenë rreth 85.8% të tyre. Në të kundërt, në 30/61 bashki, të ardhurat nga TNI mbulojnë më pak se 10% të shpenzimeve me fonde të veta për investime dhe në 46/61 bashki, të ardhurat nga TNI mbulojnë më pak se 20% të shpenzimeve për investime.


Në terma të funksioneve të qeverisjes, investimet e kryera nga bashkitë kanë pësuar luhatje nga një funksion tek tjetri

në kohë. Megjithatë, ndër vite funksioni "çështjet ekonomike" ka përthithur pjesën më të madhe të investimeve (ku ndër të tjera përfshihet infrastruktura e transportit). Në tre vitet e fundit, pesha e investimeve në këtë funksion është tkurrur nga rreth 77.6% në vitin 2015 në rreth 45.2% në vitin 2020. Bashkitë investuan rreth 5.7 miliardë lekë në funksionin e çështjeve ekonomike në vitin 2020, në rënie me rreth 37.7% krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2020, shpenzimet për investime në funksionin "strehimi dhe komoditetet e komunitetit" (ku përfshihen shpenzimet për strehimin dhe urbanistikë, ujësjellës dhe kanalizime vendore, ndriçimi publik) përfaqësuan rreth 28.8% të shpenzimeve kapitale të kryera me fondet e veta. Në këtë funksion në vitin 2020 u shpenzuan rreth 3.6 miliardë lekë, në rënie me rreth 12% në terma vjetorë.

Grafik 61. Financimi i shpenzimeve kapitale nga TNI sipas bashkive

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 62. Shpërndarja e investimeve sipas funksioneve

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Me transferimin e kompetencave të reja në lidhje me arsimin parashkollor dhe atë para-universitar në vitin 2016, bashkitë kanë rritur nivelin e investimeve në infrastrukturën arsimore. Përkatësisht, investimet në arsim në vitin 2020 regjistruan një nivel prej rreth 1.8 miliardë lekësh,

në rënie me rreth 25.7% në terma vjetorë. Në të kundërt, shpenzimet për investime në funksionin "rendi dhe siguria publike" regjistruan një nivel prej rreth 205 milionë lekë, në rritje të ndjeshme nga niveli prej rreth 51.4 milionë lekë i shënuar në vitin 2019.

Hapësirë informuese 3


Si shpenzuan 61 bashkitë në vitin 2020?

Struktura e shpenzimeve me fonde të veta të kryera nga bashkitë, së bashku me diferencat ndërmjet tyre, mbizotërohet nga shpenzimet korrente përkundëjt atyre kapitale. Në terma mesatarë për vitin 2020, në strukturën e shpenzimeve me fonde të veta, shpenzimet për personelin rënduan buxhetet vendore me rreth 43.3% ndaj totalit dhe ato operative dhe të tjera për rreth 32.1% ndaj totalit. Së bashku, shpenzimet e personelit dhe ato operative dhe të tjera, apo shpenzimet korrente, përfaqësuan mesatarisht rreth 75.4% të shpenzimeve totale me fonde të veta. Kategoria e shpenzimeve kapitale (apo fondet për investime) përfaqësoi rreth 24.6% të shpenzimeve me fonde të veta të kryera nga bashkitë në vitin 2020.

Struktura e shpenzimeve me fonde të veta paraqet diferenca ndërmjet kategorive të bashkive të grupuara sipas përmasës (shiko aneksin 4). Bashkia Tiranë, paraqet një strukturë shpenzimesh me fonde të veta që diferencon nga mesatarja kombëtare dhe nga të gjitha kategoritë e tjera të

bashkive: rreth 29.1% e fondeve shkon për mbulimin e shpenzimeve për personelin, rreth 36.3% për shpenzimet operative dhe të tjera dhe 34.7% për shpenzimet kapitale (rreth 10 pikë përqindje më shumë krahasuar me mesataren kombëtare).

Grafik 63. Struktura e shpenzimeve me fonde të veta sipas kategorive dhe përmasës së bashkive



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në bashkitë e mëdha, struktura e shpenzimeve me fonde të veta paraqet ngjashmëri me mesataren kombëtare: 44.5% e fondeve shkon për mbulimin e shpenzimeve të personelit, rreth 22.2% për investime dhe rreth 33.3% për shpenzime operative dhe të tjera. Kategoria e bashkive të mesme dhe të vogla shpenzojnë rreth 54.2% të buxhetit të tyre për shpenzimet e personelit, nivel ky ndjeshëm më i lartë krahasuar me mesataren kombëtare,


bashkitë e mëdha dhe bashkinë Tiranë. Në të kundërt, shpenzimet për investime duket të përfaqësojnë rreth 14.1% në bashkitë e mesme dhe rreth 19.8% në bashkitë e vogla, të totalit të shpenzimeve të kryera me fonde të veta të bashkive.

Krahas diferencave të evidentuara ndërmjet kategorive të bashkive, në nivelin e bashkive diferencat në strukturën e shpenzimeve me fonde

të veta janë edhe më të theksuara. Në kategorinë e bashkive të mëdha, struktura e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike paraqet diferenca të theksuara ndërmjet tyre: shpenzimet e personelit shënojnë peshën më të lartë në bashkinë Elbasan me rreth 51.2% të shpenzimeve totale me fonde të veta dhe peshën më të ulët në bashkinë

Kamëz me rreth 33.4% të shpenzimeve totale me fonde të veta të kryera në vitin 2020. Shpenzimet për investime luhaten nga një nivel minimal prej rreth 10.1% të shpenzimeve totale me fonde të veta në vitin 2020 në bashkinë Vlorë në rreth 49.4% në bashkinë Kamëz për të njëjtën periudhë.

Grafik 64. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e mëdha




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndër bashkitë e klasifikuara si të mesme, shpenzimet për personelin luhaten në intervalin nga 44.6% në bashkinë Korçë në rreth 66.2% në bashkinë Kukës, ndaj totalit të shpenzimeve të kryera me fonde të veta. Kategoria e dytë me peshë më të madhe, janë shpenzimet operative dhe të tjera të cilat luhaten nga një nivel minimal prej rreth 21.6% në bashkinë Krujë në nivelin maksimal prej rreth 43.8% në bashkinë Korçë.

Shpenzimet kapitale zënë peshën më të ulët ndër kategoritë e shpenzimeve të kryera me fonde të veta për bashkitë e mesme. Niveli minimal i shpenzimeve për kategorinë e bashkive të mesme u regjistrua në bashkinë Kurbin me rreth 3.1% të shpenzimeve të kryera me fonde të veta dhe niveli maksimal në bashkinë Krujë me rreth 20.9% të shpenzimeve të kryera me fonde të veta.

Grafik 65. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e mesme




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndër bashkitë e vogla struktura e shpenzimeve dominohet nga shpenzimet për personelin: në bashkinë Pustec regjistrohet niveli më i ulët i shpenzimeve për personelin ndaj totalit të shpenzimeve me fonde të veta prej rreth 31.4% dhe në bashkinë Divjakë regjistrohet niveli maksimal i këtij treguesi me rreth 71%. Për sa i përket shpenzimeve për investime, niveli më i lartë shënohet në bashkinë Libohovë me rreth 37.9% dhe më i ulëti në bashkinë Librazhd me rreth 2.7% të shpenzimeve të kryera me fonde të veta në vitin 2020.

Analiza e strukturës së shpenzimeve sipas natyrës ekonomike në nivel bashkie mundëson për një kuptueshmëri më të mirë të kapaciteteve të tyre në terma të orientimit të zhvillimit afatgjatë në territoret e tyre.

Mbi 60% e bashkive në vend shpenzojnë më pak se 20% të buxhetit të tyre për investime dhe vetëm rreth 10% e bashkive shpenzon mbi 30% të fondeve të veta në dispozicion për investime. Ky nivel investimesh vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm për të mundësuar zhvillimin afatgjatë të tyre dhe ndërmarrjen e projekteve të investimeve të mëdha të cilat mund të kenë ndikim të gjerë në territor.

Grafik 66. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike në bashkitë e vogla




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.2.2 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional

Kryqëzimi i të dhënave mbi shpenzimet e kryera nga bashkitë (me fonde të veta) me funksionet e kryera nga qeverisja (klasifikimi COFOG), mundëson një analizë të detajuar mbi zgjedhjet që bëjnë bashkitë në lidhje me territorin në administrim (orientimin e zhvillimit afatgjatë të tyre). Nëse do të ndanim të dhënat e disponueshme në dy periudha, para dhe pas vitit 2015 si viti me ndryshime të mëdha përsa i përket qeverisjes vendore, do të vërehej një riorientim dhe rishpërndarje e shpenzimeve ndër funksionet e ushtruara nga bashkitë.

Mesatarisht, bashkitë kanë ulur ndjeshëm (me rreth 14.7 pikë përqindje) shpenzimet në funksionin e shërbimeve të përgjithshme publike nga rreth 37.4% para vitit 2015 në rreth 22.7% pas vitit 2015. Me transferimin e kompetencave të reja në funksionin e arsimit në vitin 2016 dhe transfertës sektoriale për këtë funksion, shpenzimet në arsim shënuan rritje me rreth 10.4 pikë përqindje, nga mesatarisht 7.7% para vitit 2015 në rreth 18.1% pas vitit 2015 (ndaj totalit të shpenzimeve të kryera me fonde të veta).

Grafik 67. Shpenzimet mesatare sipas funksioneve



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet në funksionet çështjet ekonomike, strehimi dhe komoditetet e komunitetit janë funksione që së bashku përbëjnë mbi 45% të shpenzimeve me fonde të veta gjatë të gjithë periudhës së konsideruara. Për të dy këto funksione, në periudhën

pas vitit 2015 kemi një rënie të lehtë të peshës së tyre në totalin e shpenzimeve me fonde të veta (me rreth 1 dhe 2.2 pikë përqindje respektivisht). Mesatarisht në periudhën pas vitit 2015, bashkitë duket të kenë rritur shpenzimet në funksionin e mbrojtjes sociale nga 1.6%

para në rreth 3.8% ndaj totalit pas vitit 2015.


Rritja e shpenzimeve në këtë funksion deri diku, ngjashëm me arsimin, vlerësohet të jetë e lidhur me transferimin e funksioneve të reja në vitin 2016 për qendrat e shërbimeve sociale. Rritja e peshës së shpenzimeve në funksionin e mbrojtjes së mjedisit vlerësohet të jetë më shumë e lidhur me çështje metodologjike të ri-klasifikimit të programeve buxhetore në strukturën e COFOG.

Viti 2019 ishte vit zgjedhor dhe përkon me ndryshimin e drejtuesve dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë (përfshirë rastet ku mbetën të njëjtë). Analiza në terma të strukturës së shpenzimeve sipas funksioneve të qeverisjes mund të përdoret për të evidentuar nëse ka patur zhvillime në

orientimin e shpenzimeve varësisht vizionit të drejtuesve të rinj në bashki. Në këtë kontekst duhet konsideruar që krahas efektit të parë, viti 2020 ishte një vit i karakterizuar nga një sërë eventesh jo të zakonshme (tërmetet, COVID-19, përmytje), të cilët patën efektet e tyre në qeverisje dhe politikë shpenzimesh.

Në pamje të parë, struktura e shpenzimeve paraqet luhajtje ndërmjet vitit 2019 dhe 2020. Shpenzimet rezultojnë të jenë tkurrur në funksionet e çështjeve ekonomike, strehimi dhe komoditetet e komunitetit, mbrojtja sociale, argëtimi kultura dhe çështjet fetare, arsimi, shërbimet e përgjithshme publike. Në të kundërt, në rritje rezultojnë shpenzimet në funksionet rendi dhe siguria publike, mbrojtja e mjedisit dhe shëndetësia.

Grafik 68. Shpenzimet me fonde të veta sipas funksioneve



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet në funksionin çështjet ekonomike, ku përfshihen ndër të tjera shpenzimet për transportin, bujqësinë, pyjet, peshkimin dhe gjuetinë, rezultojnë të jenë ulur ndjeshëm duke regjistruar një nivel prej rreth 9.7 miliardë lekë në periudhën e konsideruar nga rreth 13.4 miliardë lekë që ishin në vitin 2019 (në rënie me rreth 27.2% në terma vjetorë apo me rreth 3.6 miliardë lekë).

Brenda këtij funksioni, rreth 7.6 miliardë lekë (-33.1% krahasuar me një vit më parë) u shpenzuan në nën-funksionin e transportit, i cili përmbledh shpenzimet në funksion të ndërtimit, rehabilitimit dhe të mirëmbajtjes së rrugëve (përfshirë sinjalistikën) dhe transportin publik. Rënia e shpenzimeve në këtë nën-funksion vlerësohet të jetë më shumë rezultat i kufizimit të transportit publik për shkak të pandemisë së COVID-19. Pësia e shpenzimeve në këtë funksion është tkurrur me rreth 5 pikë përqindje, nga rreth 23.9% në vitin 2019 në rreth 18.9% në vitin 2020 ndaj shpenzimeve totale të kryera me fonde të veta.

Gjatë vitit 2020, rreth 18.9% shpenzimeve me fonde të veta ose rreth 9.7 miliardë lekë u shpenzuan në funksionin strehimi dhe komoditetet e komunitetit (në rënie me rreth -19.6% në terma vjetorë). Ndër vite, vihet re përqendrim i shpenzimeve të bashkive në këtë funksion dhe një rritje progresive, pasi ngushtësisht i lidhur me infrastruktura vendore të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në jetën e komunitetit. Në vitin 2020, shpenzimet në këtë funksion shënuan rënie për herë të parë në 10 vitet e fundit. Brenda këtij funksioni, rreth 8.2 miliardë lekë u shpenzuan në nënfunksionin e zhvillimit të komunitetit (-21% krahasuar me një vit më parë), i cili përmban veprimtari

që synojnë përmirësimin e kontekstit të jetesës, si rekreacioni, përmirësimi i hapësirave të përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin, përmirësimi i hapësirave të gjelbra, mirëmbajtja e trotuareve, parqeve, lulishteve, etj. Diferenca prej rreth 1.5 miliardë lekësh u shpenzua për nën-funksionet e urbanistikës vendore, furnizimit me ujë dhe të ndriçimit rrugor.

Shpenzimet për funksionin e arsimit shënuan një nivel prej rreth 10.2 miliardë lekë, në rënie vjetore me rreth 5.3% dhe përfaqësuan rreth 19.9% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2020. Në terma historikë, vërehet një zgjerim progresiv i shpenzimeve në këtë funksion i cili vlerësohet të jetë pasojë e funksioneve të reja të transferuara nga qeverisja qendrore drejt asaj vendore (transferta sektoriale e cila mbulon shpenzimet për pagat e personelit mësimdhënës dhe mbështetës në kopshte dhe çerdhe, dhe personelit mbështetës në arsimin fillor dhe të mesëm; mirëmbajtës së infrastrukturës arsimore në arsimin para-universitar). Që prej vitit 2016, kjo është rënia e parë e shënuar në shpenzimet me fonde të veta për funksionin e arsimit. Për vitin 2020, rreth 7.8 miliardë lekë ose rreth 75.8% e shpenzimeve në funksionin e arsimit shkoi për mbulimin e kostove të arsimit parashkollor dhe fillor. Në nën-funksion të arsimit të mesëm u shpenzuan rreth 2.5 miliardë lekë, në rritje me rreth 7.5% në terma vjetorë.

Shpenzimet me fonde të veta në funksionin shërbimet e përgjithshme publike përthithën rreth 22.6% të shpenzimeve totale duke shënuar një nivel prej rreth 11.6 miliardë lekë në vitin 2020 (në rënie të lehtë me rreth 0.5% në terma vjetorë).

Në vitin 2020, në funksionin rendi dhe siguria publike u shpenzuan rreth 2.4 miliardë lekë, në rritje të theksuar me rreth 65.4% krahasuar me një vit më parë (shpenzimet në këtë funksion përfaqësojnë rreth 4.6% të shpenzimeve të kryera me fonde të veta). Ky funksion përmbledh shpenzime të cilat lidhen me shërbimet policore të nevojshme për ruajtjen e rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike si dhe zbulimin dhe parandalimin e informalitetit në territorin e bashkisë; shërbime të

mbrojtjes nga zjarri dhe të mbrojtjes civile; dhe shërbime të nxitjes së marrëdhënieve me komunitetin.

Funksioni i mbrojtjes sociale përthithi rreth 2.7% të shpenzimeve me fonde të veta apo rreth 1.4 miliardë lekë në vitin 2020 (funksion që përfshin shpenzime për strehimin social, papunësinë, familja dhe fëmijët, të moshuarit, sëmundje dhe paaftësitë). Në terma vjetorë, shpenzimet për mbrojtjen sociale rezultojnë të jenë ngushtuar me rreth 35.5% në terma vjetorë.

Hapësirë informuese 4

Shpenzimet me fonde të veta: si paraqiten bashkitë?


Bashkitë që rezultuan në vijim të RAT, paraqesin diferenca të theksuara në terma të shpenzimeve të kryera me fonde të veta, kushtëzuar nga: (i) numri i popullsisë rezidente në territor, si dhe (ii) kapaciteti fiskal i tyre. Për të pastruar të dhënat nga efekti "madhësi" do të marrim në analizë shpenzimet e kryera nga bashkitë me fonde të veta për një banor (shiko aneksin 7).⁴⁶ Transformimi në indekse me bazë 100, lejon për një interpretim të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe evidenton diferencat ndërmjet bashkive në lidhje me kapacitetin për të kryer shpenzime në mënyrë të pavarur.

Të dhënat për frymë për shpenzimet e kryera me fonde të veta sërish evidentojnë për diferenca të theksuara ndërmjet bashkive në mundësitë për të kryer shpenzime me fonde të veta në periudhën e konsideruar (viti 2020). Mesatarisht, një bashki shpenzoi rreth 18,323 lekë për banor në vitin 2020 (indeksi = 100), në rënie me rreth 8.1% krahasuar me nivelin e këtij treguesi në vitin 2019. Niveli maksimal i indeksit për shpenzimet me fonde të veta për frymë shënohet në bashkinë Dropull (indeksi = 261 apo në vlerë me rreth 47,738 lekë për frymë), ndjekur nga bashkia Himarë (indeksi = 257 apo në vlerë me rreth 47,164 lekë për frymë). Në skajin tjetër, bashkia Kurbin rezultoi në këtë regjistruar nivelin më të ulët të shpenzimeve me fondet të veta për frymë (indeksi = 49 apo në vlerë me rreth 8,968 lekë për frymë), ndjekur nga bashkitë Krujë (indeksi = 57 apo në vlerë me rreth 10,358 lekë për frymë), Peqin (indeksi = 57 apo në vlerë me rreth 10,458 lekë për frymë), Cërrik (indeksi = 64 apo në vlerë me rreth 11,755 lekë për frymë) dhe Dibër (indeksi = 65 apo në vlerë me rreth 11,865 lekë për frymë). Në raport ndaj mesatares kombëtare,

rreth 30% e bashkive (apo 18/61 bashki) kryejnë shpenzime me fonde të veta për frymë mbi mesataren kombëtare. Pjesa tjetër e bashkive (43/61 bashki) qëndron nën mesataren kombëtare në lidhje me treguesin në analizë (shiko grafikun 69).

Diferenca e theksuar mes nivelit minimal dhe maksimal të shpenzimeve për frymë me fonde të veta (rreth 2.1 herë më e lartë se mesatarja kombëtare apo rreth 38,770 lekë), sinjalizon për ekzistencën e diferencave të thella në kapacitete fiskale të bashkive dhe nevojën për zbutjen e tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve publike vendore. Si hap fillestar në këtë drejtim vlerësohet të adresohet llogaritja e kapaciteteve fiskale potenciale të bashkive dhe më tej vlerësimi i performancës së tyre kundrejt potencialit. Më tej, treguesi i performancës që lidhet me normën e mbledhjes së të ardhurave mund të faktorizohet në formulën e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, si element stimuli për të nxitur shfrytëzimin e hapësirës fiskale të përcaktuar ligjërisht.

Grafik 69. Indeksi i shpenzimeve me fonde të veta (bashkitë përkundrejt mesatares)




2.3 Shpenzimet e kryera me fonde nga transferta të kushtëzuara

Krahas shpenzimeve me fonde nga burime të veta, bashkitë kryejnë shpenzime edhe me fonde të kushtëzuara (fonde të cilat transferohen nga institucione qendrore, si ministrinë e linjës, dhe që duhet të përdoren sipas qëllimit të përcaktuar). Për këtë kategori të hyrash në buxhetin vendor, bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrjeje në sasinë apo mënyrën e përdorimit: pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, quhen fonde me destinacion të përcaktuar). Këto fonde transferohen nga buxhetet e ministrive të linjës në trajtën e transfertave të kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara dhe/ose projekteve të

veçanta të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar ku kërkohet bashkëpunimi me bashkitë. Ato planifikohen në buxhetet vjetore dhe planet buxhetore afatmesme të ministrive përkatëse. Raporti i zbatimit të buxhetit vjetor të ministrisë të linjës përmban një aneks të dedikuar ku paraqiten transfertat e kushtëzuara, qëllimi i përdorimit të tyre, përfituesi, vlera totale, shuma e lëvruar dhe pjesa e mbetur për tu financuar në vitet në vijim për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndonëse të parashikuara dhe të transferuara nga buxhetet e njësive qendrore të qeverisjes (si ministrinë e linjës), ato reflektohen në totalin e shpenzimeve të kryera prej bashkive.

Grafik 70. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara kanë qenë të luhatshme nga viti në vit dhe shfaqin prirje rritëse. Kjo prirje është më e dukshme veçanërisht në vijim të ndryshimeve të aplikuara në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjet në


nevojë. Pas një rënie me rreth 12.6% të shënuar në vitin 2019, shpenzimet me fonde të kushtëzuara në vitin 2020 shënuan nivelin më të lartë historik prej rreth 38.9 miliardë lekësh, në rritje me rreth 31.6% në terma vjetorë.

2.3.1 Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas klasifikimit ekonomik

Bazuar në klasifikimin ekonomik, rreth 76.3% e shpenzimeve me fonde të kushtëzuara u përqendrua në mbulimin e shpenzimeve korrente (të cilat përbëhen kryesisht nga transfertat për

buxhetet familjare - ndihmë ekonomike, pagesa e paaftësisë etj.) dhe rreth 23.7% në mbulimin e shpenzimeve kapitale (investime përfshirë fondet e dhëna nga FZHR-ja).

Grafik 71. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas natyrës ekonomike



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Shpenzimet korrente me fonde të kushtëzuara shënuan një nivel prej rreth 29.7 miliardë lekë, në rritje me rreth 32.7% në terma vjetorë. Në këtë

kategori, shpenzimet për transfertat për buxhetet familjare zënë rreth 70.2% të shpenzimeve korrente dhe shënuan një nivel prej rreth 27.3 miliardë lekë në vitin

2020. Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për transfertat për buxhetet familjare shënuan rritje me rreth 34.1% në terma vjetorë apo rreth 7 miliardë lekë. Rritja e shpenzimeve në këtë kategori vjen si pasojë e rritjes së nivelit

të ndihmës ekonomike dhe pagesës së paaftësisë përgjatë periudhës së COVID-19 (masë e cila pritët të jetë aktive edhe përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021).

Grafik 72. Shpenzimet korrente me fonde të kushtëzuara




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara paraqiten të luhatshme nga viti në vit dhe shënuan një rritje të ndjeshme në vitin 2017. Në vitin 2020, shpenzimet për investime shënuan një nivel prej rreth 9.2 miliardë lekë, në rritje me rreth 28% krahasuar me një vit më parë. Mbi 75% e fondeve të kushtëzuara për investime janë të destinuara për funksionin që përmbledh shpenzimet për strehimin dhe komoditetet e komunitetit (në rritje me rreth 85.5% në terma vjetorë dhe rreth 13.3% në funksionin e arsimit (në rënie me rreth 50% krahasuar me një vit më parë).


Në vitin 2020, bashkia Durrës përftoi rreth 5.8% të fondeve të kushtëzuara për investime ndjekur nga bashkitë Kavajë (5.5%) dhe Kurbin (4.6%). Bashkitë Belsh, Dibër, Skrapar, Kolonjë, Rrogozhinë, Finiq, Malësi e Madhe, Tiranë dhe Fier janë përftues të 3-4% të fondeve të kushtëzuara për investime. Në të kundërt, bashkitë Delvinë, Maliq, Konispol, Tepelenë, Kukës, Pustec, Korçë etj. përftuan fonde të kushtëzuara për investime mesatarisht nën 0.5% të totalit.

Grafik 73. Shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Grafik 74. Shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara sipas bashkive (viti 2020)


Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

2.3.2 Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas klasifikimit funksional

Në organizimin e të dhënave për shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas funksioneve të qeverisjes, rreth 63% e shpenzimeve me fonde të kushtëzuara u shpenzua për funksionin e mbrojtjes sociale, në rritje me rreth 19.1% në terma vjetorë. Zgjerimi i shpenzimeve me fonde të kushtëzuara për mbrojtjen sociale lidhet me rritjen e miratuar nga qeveria qendrore për transfertat për buxhetet familjare në periudhën e COVID-19. Funksioni i dytë në të cilin u shpenzuan rreth 29.2% e transfertave të kushtëzuara është ai që

përmbledh shpenzimet në strehim dhe komoditete të komunitetit. Shpenzimet në këtë funksion shënuan rritje të theksuar nga 4.7 miliardë lekë në vitin 2019 në rreth 11.4 miliardë lekë në vitin 2020, rreth 59.1% e të cilave është kanalizuar në shërbimin e furnizimit me ujë. Në funksionin e arsimit u shpenzuan rreth 3.7% e fondeve të kushtëzuara, në rënie me rreth 45% në terma vjetorë (pjesa më e madhe e të cilëve në mbulimin e kostove për ofrimin e shërbimit të arsimit të mesëm).

Grafik 75. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas funksioneve të qeverisjes


Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.4 Sa shpenzuan bashkitë në vitin 2020?

Në total, 61 bashkitë në vend shpenzuan mesatarisht rreth 32,224 lekë për frymë përgjatë vitit 2020, në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligj. Sipas burimit të financimit, shpenzimet me fonde të veta rezultojnë të jenë rreth 18,323 lekë për frymë (në rënie me rreth 8.1% në terma vjetorë) dhe me fonde të kushtëzuara rreth 13,900 lekë për frymë (+31.6% në terma vjetorë).

Pavarësisht burimit të financimit, në funksion të qeverisjes vendore u shpenzuan rreth 90.2 miliardë lekë⁴⁷ në fund të vitit 2020, në rritje me rreth 5.6% në terma vjetorë. Zgjerimi i shpenzimeve në terma vjetorë u përcaktua gjerësisht nga rritja e shpenzimeve me fonde të kushtëzuara (nën efektin e rritjes së transfertave për buxhetet familjare gjatë periudhës së COVID-19). Në terma nominalë, rreth 51.3 miliardë lekë ishin shpenzime me fonde të veta (në rënie vjetore me rreth -8.1%) dhe rreth 38.9 miliardë lekë ishin shpenzime me fonde të kushtëzuara (në rritje vjetore me rreth +31.6%).

Grafik 76. Përdorimi i burimeve financiare totale




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në kategorinë e shpenzimeve me fonde të veta, kahu i zhvillimeve u përcaktua nga tkurrja e investimeve me rreth 28.3% krahasuar me një vit më parë. Në të kundërt, në shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara, kahu i zhvillimeve u përcaktua nga zgjerimi i shpenzimeve operative dhe të tjera (rritja e transfertave për buxhetet familjare). Në të gjithë periudhën e konsideruar, shpenzimet korrente kanë peshë mbizotëruese dhe kanë ndjekur prirje rritëse përgjatë periudhës 2015-2020. Në vitin 2020, shpenzimet korrente përfaqësuan rreth 75.8% dhe shpenzimet kapitale rreth 24.2% të shpenzimeve totale të kryera.

Gjatë vitit 2020, shpenzimet korrente totale shënuan një nivel prej rreth 68.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 12.8% në terma vjetorë. Zgjerimi i shpenzimeve korrente u diktua në masë të madhe nga rritja e shpenzimeve operative dhe të tjera: në vitin 2020 bashkitë shpenzuan rreth 45.5 miliardë lekë për shpenzimet operative dhe të tjera (në këtë kategori peshë të rëndësishme zënë shpenzimet për transfertat në buxhetet familjare, ndihmë ekonomike dhe pagesë paafësie), në rritje me rreth 8.5% në terma vjetorë. Në të njëjtin kah, por në masë më të vogël, kontribuoi, gjithashtu, rritja e shpenzimeve me rreth 2% e shpenzimeve për personelin.

Grafik 77. Shpenzimeve kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet për investime shënuan një nivel prej rreth 21.9 miliardë lekë dhe regjistruan një rënie vjetore prej rreth 11.9% në terma vjetorë. Rritja e shpenzimeve kapitale me fonde të kushtëzuara nuk arriti të kundër bilancojë tkurrjen e shpenzimeve kapitale me fonde të veta të bashkive përgjatë vitit 2020. Raporti i shpenzimeve kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale të kryera nga bashkitë është një tregues i cili mund të përdoret për të vlerësuar orientimin e bashkive dhe forcën e tyre për të përmbushur vizionin zhvillimor afatgjatë. Sa më i lartë ky tregues dhe veçanërisht nëse mbi 50%, aq më e ulët aftësia e bashkisë për të ecuar në mënyrë të pavarur në drejtim të objektivave afatgjatë (dhe anasjelltas). Mesatarisht për 61 bashkitë në vend, shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara përfaqësojnë rreth 42.3% të shpenzimeve kapitale totale (për vitin 2020). Ky raport rezulton të jetë rreth 13.2 pikë përqindje më i lartë se ai i shënuar në vitin 2019 dhe rreth 18.8 pikë përqindje më i lartë krahasuar me nivelin e shënuar në vitin 2015. Për bashkinë Tiranë, ky raport shënon vlerë minimale në vitin 2020 prej rreth 4.3% ndërsa mesatarja e 60 bashkive të tjera është rreth 58.8%.

Në nivel bashkie, shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara përfaqësojnë mbi 50% të shpenzimeve kapitale totale të kryera në vitin 2020 në rreth 39/61 bashki. Niveli më i lartë i treguesit u shënuar në bashkinë Kurbin (rreth 97.2%), ndjekur nga bashkitë Këlcyrë (92.5%) dhe Libohovë (91.7%). Në bashkitë Dibër, Poliçan, Belsh, Skrapar, Kuçovë, Peqin, Finiq dhe Kolonjë shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara përfaqësojnë mbi 80% të shpenzimeve kapitale; në bashkitë Gjirokastrë, Malësi e Madhe, Bulqizë, Tepelenë, Mat, Pukë, Kavajë, Klos, dhe Mirditë, shpenzimet kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj totalit të shpenzimeve kapitale luhaten në intervalin 70% - 80% etj. Në të kundërt, në bashkitë Tiranë, Delvinë, Maliq, Memaliaj raporti i shpenzimeve me fonde të kushtëzuara ndaj totalit shënon vlera nën 10% për vitin 2020; në bashkitë Korçë, Shkodër, Sarandë, Kamëz, Berat dhe Himarë luhatet në intervalin 10% - 20% etj. (shiko grafikun 76).

Grafik 78. shpenzimeve kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale



Hapësirë informuese 5


Shpenzimet e personelit dhe numri i të punësuarve në 61 bashki⁴⁸

Eficienca dhe efektiviteti në përdorimin e burimeve financiare në dispozicion mbetet një sfidë për t'u adresuar nga të gjitha vendet. Kjo sfidë bëhet edhe më e rëndësishme sidomos në vendet në zhvillim ku burimet financiare janë të kufizuara dhe për rrjedhojë nuk arrihet të përmbushen nevojat për shërbime publike qoftë në nivel qendror ashtu dhe në atë vendor. Tashmë kanë kaluar plot 5 vite nga RAT, ku krahas ri-konfigurimit territorial bashkitë ristrukturuan edhe burimet njerëzore dhe strukturat organizative të tyre për një shërbim më cilësor dhe me ekonomi të komuniteteve përkatëse. Një analizë e kostove të personelit dhe numrit të të punësuarve në bashki, lidhet drejtpërdrejtë me një ndër qëllimet e RAT dhe reformave të tjera decentralizuese, atë të rritjes së eficiencës në administrimin e burimeve në dispozicion.⁴⁹


Të dhënat historike tregojnë se komponenti i shpenzimeve të personelit ka rritur peshën e tij në buxhetet vendore, nga mesatarisht rreth 19.1% në periudhën 2010-2015 në mesatarisht me rreth 25.1% në periudhën 2016-2020.⁵⁰ Në vitin 2020, shpenzimet e personelit totale (me fonde të veta dhe të kushtëzuara) përfaqësuan rreth 25.4% të shpenzimeve totale të kryera nga 61 bashkitë, ndër të cilat rreth 97% të mbuluara me fonde të veta të bashkive. Mesatarisht, kosto për një të punësuar në bashki ishte rreth 54,324 lekë në muaj në vitin 2020. Kosto mesatare për të punësuar regjistrin nivelin më të lartë në bashkitë Tiranë, ndjekur nga bashkitë Belsh, Kamëz, Vlorë, Elbasan, Durrës, Gramsh, Krujë etj. Në të kundërt, kosto mesatare për të punësuar shënon nivelin më të ulët në bashkinë Këlcyrë, ndjekur nga bashkitë Përmet, Divjakë, Pustec, Vorë, Pogradec etj. Në 17/61 bashki, kosto mesatare për të punësuar rezulton të jetë mbi mesataren e 61 bashkive, në 4/61 bashki pranë nivelit mesatar dhe në 40 /61 bashki nën nivelin mesatar të 16 bashkive.⁵¹

Për vitin 2020 numri total i punonjësve në 61 bashkitë në vend ishte afërsisht 34,047 të punësuar, në rritje me rreth 2.7% krahasuar me një vit më parë (apo rreth 901 punonjës më shumë). Rreth 50% e shtesës së të punësuarve në vitin 2020, u punësuan nga bashkia Tiranë, ndjekur nga bashkitë Pogradec (+130 të punësuar), Durrës (+81 të punësuar), Mat (+46 të punësuar), Vau i Dejës (+38 të punësuar) etj. Në të kundërt, numri i të punësuarve është pakësuar ndjeshëm në bashkitë Dibër (-63 të punësuar), Kamëz (-53 të punësuar), Lezhë (-52 të punësuar) etj. Në raport me numrin e të punësuarve mesatar vjetor në sektorin shtetëror,⁵² të punësuarit në 61 bashkitë në vend përfaqësuan rreth 19.4% ndaj totalit. Ndërsa, krahasuar me numrin total të punonjësve në qeverisjen qendrore për vitin 2019,⁵³ të punësuarit në nivel vendor (61 bashki) përfaqësuan rreth 41.4%.

Grafik 79. Kosto mesatare mujore për të punësuar në bashki



Grafik 80. Numri i të punësuarve (në total dhe sipas bashkive)



Burimi: www.financatvendore.al & Faqe interneti zyrtare të bashkive


Numri i të punësuarve në bashki paraqitet ngushtësisht i lidhur me përmasën e bashkisë në terma të numrit të popullsisë.⁵⁴ Në bashkitë e mëdha gjendet i përqendruar numri më i lartë i të punësuarve: të punësuarit në bashkinë Tiranë përfaqësuan rreth 21.2% të të punësuarve total, ndjekur nga bashkia Durrës me rreth 4.9% të tyre. Në bashkinë Elbasan dhe Fier janë të punësuar respektivisht 4% dhe 3.8% e të punësuarve total në nivel bashkie ndjekur nga bashkitë Vlorë (3%), Korçë (3%), Shkodër (2.8%), Lushnje (2.6%) etj.

Analiza në terma nominalë e numrit të të punësuarve dhe shpenzimeve për personelin janë një hap i parë për të vlerësuar mbi ofrimin e shërbimeve publike vendore dhe përdorimin e burimeve financiare në dispozicion. Një tregues i përdorur gjerësisht në literaturë për të vlerësuar mbi nivelin e ofrimit të shërbimeve publike vendore është numri i të punësuarve për 1,000 banorë⁵⁵ Niveli mesatar i treguesit për 61 bashkitë në vend vlerësohet në rreth 12 punonjës për 1,000 banorë, me një nivel minimal prej rreth 6 të punësuar për 1,000 banorë në bashkinë Kamëz dhe nivel maksimal prej rreth 38 të punësuar për 1,000 banorë në bashkinë

Dropull. Numri mesatar i të punësuarve për 1,000 banorë vlerësohet të qëndrojë nën nivelin referencë të përdorur nga Banka Botërore prej më pak se 25 punonjës për 1,000 banorë. Krahësuar me nivelin referencë të përdorur nga Banka Botërore prej më pak se 25 punonjës për 1,000 banorë, rezulton se 54 bashki kanë një nivel më të ulët se referenca dhe 2 bashki kanë një nivel të punësuarish për 1,000 banorë pranë vlerës referencë. Në të kundërt, 5/61 bashki qëndrojnë mbi këtë nivel reference, duke sugjeruar për mbi-ngarkesë të punonjësve bashkiakë në raport me popullsinë e bashkisë.⁵⁶

Rreth 37/61 bashki në vend rezultojnë të regjistrojnë një nivel të këtij treguesi mbi mesataren kombëtare si bashkitë: Dropull (38 punonjës për 1,000 banorë), Këlcyre (31 punonjës për 1,000 banorë), Përmet (29 punonjës për 1,000 banorë), Fushë Arrëz (29 punonjës për 1,000 banorë), Skrapar (28 punonjës për 1,000 banorë), Tepelenë (25 punonjës për 1,000 banorë), Pukë (25 punonjës për 1,000 banorë) etj. Në të kundërt, në bashkitë Kamëz, Shkodër, Krujë, Kurbin, Durrës, Cërrik etj. regjistrohet një nivel të punësuarish për 1,000 banorë ndjeshëm nën mesataren kombëtare.

Grafik 81. Të punësuar në bashki për 1,000 banorë



Burimi: Instat, MFE, Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Numri i të punësuarve në 61 bashkitë në vend u zgjerua për të dytin vit duke rënduar kostot në buxhetet vendore. Janë rreth 34,047 të punësuar në 61 bashkitë në vend apo rreth 12 të punësuar për 1,000 banorë. Diferencat ndërmjet bashkive janë të theksuara, si në nivel të kostos mesatare për të punësuar ashtu dhe në nivelin e ofrimit të shërbimit vlerësuar nga treguesi i numrit të punësuarve për 1,000 banorë. Të dy këto tregues, ngrenë pikëpyetje mbi nivelin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve nga qeverisja vendore (bashkitë në vend). Kjo e fundit, gërshetuar dhe me mungesën e studimeve të thelluara mbi kostot e ofrimit të shërbimeve publike vendore dhe standardeve përkatëse, krijojnë paqartësi dhe nuk mundësojnë për zgjidhje optimale në lidhje me numrin e të punësuarve në bashki.

3 PËRFUNDIME

Viti 2020 ishte një vit intensiv, ku krahas dëmeve të mëdha të lëna pas nga tërmetet e fundvitit 2019 (tërmeti i 21 Shtatorit dhe 26 Nëntorit 2019) u mbivendosën efektet e menjëhershme të krizës shëndetësore të shkaktuara nga COVID-19. Përballja me këto vështirësi nënvizoi edhe një herë rëndësinë e bashkive në jetën e komuniteteve që ato përfaqësojnë dhe rolin e dobët që ato patën në administrimin e krizës. Bazuar në analizën e të dhënave mbi burimet e të ardhurave dhe përdorimin e tyre nga 61 bashkitë në vend mund të nxjerrim disa përfundime.

Torta e burimeve financiare në dispozicion të bashkive është rritur ndonëse kjo rritje nuk është proporcionale për të gjitha bashkitë.

Struktura e të ardhurave dominohet nga transfertat ndërqeveritare, ndërsa të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë peshë të ulët. Në këto të fundit, rol kryesor luajnë të ardhurat nga TNI dhe taksa e ndërtesës (mbledhur kryesisht në bashkinë Tiranë).

61 bashkitë në vend paraqesin diferenca të theksuara ndërmjet tyre, në terma të burimeve financiare në dispozicion. Për pasojë, janë krijuar grupime të bashkive: (i) bashkia Tiranë, që operon dhe paraqet diferenca të theksuara me 60 bashkitë e tjera; (ii) bashkitë e mëdha që ndërmjet tyre paraqesin ngjashmëri por diferencojnë shumë nga bashkia Tiranë; (iii) bashki të mesme të cilat paraqesin ngjashmëri mes tyre por kanë diferenca të theksuara me bashkinë Tiranë dhe bashkitë e mëdha; (iv) bashkitë e vogla që paraqesin ngjashmëri mes tyre dhe diferencohen ndjeshëm nga të gjitha bashkitë e tjera. Përballë të njëjtave detyrime dhe përgjegjësi, hende ku ekzistues në kapacitete administrative dhe financiare e bën të pamundur përmbushjen e tyre.

Hapësira fiskale në dispozicion vlerësohet të mos shfrytëzohet plotësisht, veçanërisht në lidhje me taksapaguesit familjarë. Rritja e nivelit të detyrimeve vendore (taksat dhe tarifat vendore) nuk është materializuar në rritje të të ardhurave në burimet e veta

4 ANEKSE

Aneks 1.

Shënim metodologjik

Burimi i të dhënave për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV) të nivelit të parë (bashkitë) të përdorura në Raportin e Financave Publike Vendore -Status Raport 2020 është Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit, SIFQ) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, publikuar në faqen zyrtare të MFE, të cilat janë përpunuar dhe më pas publikuar në platformën www.financatvendore.al. Të dhënat janë kumulative (ose stok në fund të periudhës), të shprehura në monedhë vendase (lekë) dhe u referohen vetëm 61 bashkive (12 qarqet nuk janë të përfshirë në analizë). Për të mundësuar krahasimet historike me periudhën përpara zbatimit të reformës administrative dhe territoriale (RAT), të dhënat për periudhën 2010-2015 për 373 njësi të vetëqeverisjes vendore u ri-klasifikuan në nivelin e 61 bashkive të reja të krijuara në vijim të RAT.

Për qëllim analize të dhënat e marra nga SIFQ në formë bruto janë klasifikuar nga autorët duke ndjekur gjerësisht përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",

Udhëzimet Vjetore të ndara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm dhe praktikën ndërkombëtare përkatëse. Të dhënat për të ardhurat janë kategorizuar në përputhje me sa lartpërmendur në:

- të ardhura nga burime të veta vendore që përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, tarifat dhe të tjera;
- të ardhura nga taksa të ndara sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- transferta të pakushtëzuara dhe sektoriale; dhe
- transferta të kushtëzuara nga ministritë e linjës për funksione të deleguara dhe/ose investime.

Tre kategoritë e para janë klasifikuar nën emërtimin e përbashkët të burimeve financiare të disponueshme, burime mbi të cilat bashkitë kanë të drejta vendimmarrje relative në lidhje me mënyrën e përdorimit. Ndërsa, mbi kategorinë e transfertave të kushtëzuara bashkitë nuk kanë autoritet

vendimmarrjeje në lidhje me sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve; pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, janë fonde me destinacion të përcaktuar).

Për simetri me mënyrën e organizimit të të dhënave mbi të ardhurat sipas burimit, analiza e shpenzimeve do të organizohet në dy kategori kryesore:

- shpenzime të kryera me fonde të veta të bashkive (ku përfshihen të ardhurat nga burimet e veta, taksat e ndara, transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale);
- shpenzime të kryera me fonde të kushtëzuara (ku do të përfshihen ato kategori shpenzimesh të mbuluara me fonde nga transfertat e kushtëzuara nga ministritë e linjës, përfshirë fondet për investime nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR);
- Për të dy kategoritë, si me fonde të veta ashtu dhe me fonde të kushtëzuara, shpenzimet do të paraqiten sipas natyrës ekonomike të tyre dhe sipas funksioneve të qeverisjes vendore (COFOG).

Ky raport është pjesë e një serie raportesh me frekuencë tremujore dhe vjetore për financat vendore përgatitur nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Raportet e mëparshme mund të gjenden në: <http://www.financatvendore.al/pub/raporte>.

Për një panoramë të përgjithshme për secilën prej 61 bashkive, mund të konsultoni Profilët e Bashkive në: <http://www.financatvendore.al/analiza/profilet>.

Aneks 2.

Funksionet e bashkive sipas legjislacionit në fuqi

* Sipas ligjit nr. 139/2015 "Për funksionet e vetëqeverisjes vendore"

Fusha	Funksionet
Infrastruktura dhe shërbimet publike	• Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. • Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. • Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara. • Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore. • Ndriçimin e mjediseve publike. • Transportin publik vendor. • Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit. • Shërbimin e dekorit publik. • Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. • Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake. • Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale. • Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe. • Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik. • Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit.
Shërbimet sociale	• Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj. • Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social. • Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. • Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve.

Fusha	Funksionet
Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese	- Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. - Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. - Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve. - Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
Mbrojtja e mjedisit	- Sigurimin në nivel vendor të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja. - Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. - Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
Bujqësia, zhvillimi rural, pyjet dhe kullotat publike, natyra dhe biodiversiteti	- Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre. - Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj. - Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural. - Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor. - Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik. - Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit.
Zhvillimi ekonomik vendor	- Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik vendor. - Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë. - Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.

Fusha	Funksionet
Zhvillimi ekonomik vendor	- Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj. - Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj. - Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.
Siguria publike	- Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse. - Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse. - Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet. - Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor.

Aneks 3.
Listë e treguesve kryesorë të përdorur

Treguesi	Përshkrimi	Vlera			
		2015	2018	2019	2020
1. Të ardhura nga burimet e veta vendore ndaj PBB-së nominale (%)	Shuma të ardhurave nga taksa, tarifa vendore në lekë dhe të tjera ndaj PBB-së nominale në lekë.	0.9%	1.5%	1.5%	1.5%
2. Të ardhura nga burime financiare të disponueshme ndaj PBB-së nominale (%)	Shuma të ardhurave nga burimet e veta vendore, transfertat e pakushtëzuara (e përgjithshme dhe sektoriale) dhe taksa të ndara në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	1.8%	3.0%	3.1%	3.3%
3. Burime financiare totale ndaj PBB-së nominale (%)	Shuma e të ardhurave (mjete financiare) nga burimet e veta vendore, transfertat ndërqeveritare të kushtëzuara, të pakushtëzuara dhe taksa të ndara në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	3.6%	5.0%	4.8%	5.8%
4. Të ardhura nga burimet e veta vendore ndaj të ardhurave totale të qeverisë së përgjithshme (%)	Shuma të ardhurave nga taksa, tarifa vendore dhe të tjera në lekë ndaj të ardhurave totale të qeverisë së përgjithshme në lekë.	3.4%	5.4%	5.6%	5.7%
5. Të ardhura nga burime financiare të disponueshme ndaj të ardhurave totale të qeverisë së përgjithshme (%)	Shuma të ardhurave nga burimet e veta vendore, transfertat e pakushtëzuara (e përgjithshme dhe sektoriale) dhe taksa të ndara në lekë ndaj të ardhurave totale të qeverisë së përgjithshme në lekë.	6.7%	10.9%	11.3%	12.2%
6. Autonomia financiare (A)	Raporti i të ardhurave nga burimet e veta vendore ndaj totalit të burimeve financiare vjetore.	25.20%	29.10%	31.40%	26.60%
7. Autonomia financiare (B)	Raport i të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe taksave të ndara ndaj totalit të burimeve financiare vjetore;	30.90%	30.90%	33.40%	29.10%
8. Autonomia financiare (C)	Raport i të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe taksave të ndara dhe transfertave të pakushtëzuara (të përgjithshme dhe specifike) ndaj totalit të burimeve financiare vjetore.	59.30%	59.30%	63.70%	57.20%

Treguesi	Përshkrimi	Vlera			
		2015	2018	2019	2020
9. Shpenzime me fonde të veta ndaj PBB-së (%)	Shpenzime të kryera me fonde nga burimet e veta vendore, transfertat e pakushtëzuara (të përgjithshme dhe sektoriale) dhe taksat e ndara në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	2.3%	2.9%	3.3%	3.2%
10. Shpenzime me fonde të kushtëzuara ndaj PBB-së (%)	Shpenzime të kryera me fonde nga transfertat e kushtëzuara në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	1.8%	2.1%	1.8%	2.5%
11. Shpenzime totale ndaj PBB-së (%)	Shpenzime totale (të kryera me fonde të veta dhe të kushtëzuara) në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	4.1%	5.0%	5.1%	5.7%
12. Shpenzime me fonde të veta ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme (%)	Shpenzime të kryera me fonde nga burimet e veta vendore, transfertat e pakushtëzuara (të përgjithshme dhe sektoriale) dhe taksat e ndara në lekë ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme në lekë.	7.5%	10.1%	11.4%	9.6%
13. Shpenzime totale ndaj shpenzimeve qeverisë së përgjithshme (%)	Shpenzime totale (të kryera me fonde të veta dhe të kushtëzuara) në lekë ndaj shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme në lekë.	13.5%	17.3%	17.4%	16.8%
14. Investimet publike ndaj PBB-së (%)	Investimet publike totale në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	4.4%	4.8%	4.4%	5.4%
15. Investimet bashkitë ndaj PBB-së (%)	Investimet totale të kryera nga bashkitë në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	1.2%	1.4%	1.5%	1.4%
16. Investimet me fonde të veta ndaj PBB-së (%)	Investime të kryera me fondet e veta të bashkive (nga burimet e veta vendore, transfertat e pakushtëzuara dhe taksa të ndara) në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	0.9%	0.8%	1.0%	0.8%
17. Investimet me fonde të veta ndaj investimeve publike totale (%)	Investime të kryera me fondet e veta të bashkive (nga burimet e veta vendore, transfertat e pakushtëzuara dhe taksa të ndara) në lekë ndaj investimeve publike totale në lekë.	20.1%	16.7%	23.5%	14.8%
18. Investime bashkitë ndaj investimeve publike (%)	Investime totale të kryera nga bashkitë (me fonde të veta dhe të kushtëzuara, përfshirë FZHR) në lekë ndaj investimeve publike totale në lekë.	26.2%	29.8%	33.1%	25.7%

Treguesi	Përshkrimi	Vlera			
19. Borxhi ndaj PBB-së (në %)	Pesha e vlerës së mbetur të kredive të marra nga bashkitë në fund të vitit në lekë ndaj PBB-së nominale në lekë.	0.049%	0.043%	0.035%	0.026%
20. Detyrimet e prapambetura ndaj PBB-së (%)	Raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura në lekë në fund të periudhës ndaj PBB-së nominale në lekë.		0.41%	0.50%	0.42%
21. Detyrimet e prapambetura për frymë (në lekë)	Raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj popullsisë sipas Census 2011.			2,918 lekë	2,475 lekë
22. Treguesi i paaftësisë paguese	Raporti i borxheve afatgjata dhe detyrimeve të papaguara në lekë ndaj shpenzimeve vjetore të mirat-uara në lekë, për 61 bashkitë për vitin 2020				
23. Kosto mesatare për të punësuar (lekë në muaj)	Raporti i shpenzimeve për personelin në lekë ndaj numrit të të punësuarve në bashki (sipas bashkive dhe në total), pjesëtuar për 12 muaj			54,395 lekë	54,324 lekë
24. Numri i të punësuarve në bashki për 1,000 banorë	Raporti i numrit të punësuarve në bashki ndaj popullsisë (të shprehur në 1,000 banorë)		11.0	11.5	12
25. Shpenzime kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale totale shpenzimeve kapitale totale	Raporti i shpenzime kapitale me fonde të kushtëzuara ndaj shpenzimeve kapitale totale në lekë.				
	Mesatare 61 bashki	23.5%	44.0%	29.1%	42.3%
	Bashkia Tiranë	7.3%	22.7%	6.0%	4.3%
	Mesatare 60 bashki (përfshirë bashkinë Tiranë)	27.4%	52.6%	41.2%	58.8%
26. Financimi i shpenzimeve kapitale nga të ardhurat nga TNI	Raport i të ardhurave nga TNI ndaj shpenzimeve kapitale me fonde të veta në lekë.				
	Mesatare 61 bashki	11.2%	55.3%	47.9%	62.8%
	Bashkia Tiranë	20.2%	104.6%	77.4%	100.6%
	Mesatare 60 bashki (përfshirë bashkinë Tiranë)	8.5%	22.4%	23.2%	24.7%

Aneks 4.
Bashkitë sipas numrit të popullsisë

Kriteri	Grupi	Bashkia
Deri në 40,000 banorë	Bashki të vogla (43/61)	Pustec, Dropull, Libohovë Këlcyrë, Fushë Arrëz, Delvinë, Himarë, Konispol, Tepelenë, Finiq, Përmet, Memaliaj, Poliçan, Pukë, Kolonjë, Skrapar, Selenicë, Klos, Has, Belsh, Sarandë, Tropojë, Roskovec, Mirditë, Rrogozhinë, Patos, Gramsh, Përrenjas, Vorë, Peqin, Devoll, Mallakastër, Ura Vajguore, Cërrik, Mat, Shijak, Gjirokastër, Vau i Dejës, Malësi e Madhe, Bulqizë, Kuçovë, Librazhd, Divjakë
40,001 - 100,000 banorë	Bashki të mesme (11/61)	Kavajë, Maliq, Kurbin, Kukës, Krujë, Berat, Pogradec, Dibër, Lezhë, Korçë, Lushnjë
> 100,000 banorë	Bashki të mëdha (6/61)	Kamëz, Vlorë, Fier, Shkodër Elbasan, Durrës
557,422 banorë	Bashkia Tiranë (1/61)	Tiranë

Aneks 5.
Të ardhura nga burimet e veta vendore për frymë

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Mesatare 2018- 2020	Indeks Mesatarja 100
Belsh	969	4,012	2,158	1,880	2,367	2,986	2,411	27.4
Berat	4,449	4,296	5,742	5,128	4,868	5,228	5,075	57.6
Bulqizë	1,192	1,382	1,765	1,371	1,626	1,373	1,457	16.5
Cërrik	2,055	3,611	2,699	2,687	3,137	3,319	3,048	34.6
Delvinë	2,738	6,103	5,808	3,363	3,808	4,724	3,965	45.0
Devoll	1,771	2,406	2,298	2,749	3,978	3,673	3,467	39.4
Dibër	993	1,065	1,103	1,034	1,605	1,316	1,318	15.0
Divjakë	2,105	2,712	2,261	2,847	2,871	2,586	2,768	31.4
Dropulli	10,739	13,810	13,897	12,487	13,742	19,164	15,131	171.8
Durrës	6,712	6,739	7,451	6,948	7,032	5,278	6,419	72.9
Elbasan	3,579	3,849	4,449	4,556	5,270	5,081	4,969	56.4
Fier	3,983	3,638	4,340	5,116	5,556	5,049	5,241	59.5
Finiq	3,107	4,879	5,574	5,782	5,465	6,349	5,865	66.6
FushëArrëz	1,727	2,631	2,627	2,625	2,696	1,704	2,342	26.6
Gjirokastrë	4,769	4,854	4,707	5,244	5,696	5,430	5,457	62.0
Gramsh	2,502	1,709	2,239	2,540	2,162	2,259	2,320	26.3
Has	718	716	841	774	757	997	843	9.6
Himarë	14,007	20,763	19,770	23,204	31,497	40,388	31,696	359.9
Kamëz	3,921	4,794	5,529	7,509	7,612	4,710	6,610	75.1
Kavajë	5,830	6,926	8,256	9,357	9,633	7,576	8,855	100.6
Këlcyrë	1,803	1,553	1,734	1,903	1,405	1,509	1,605	18.2
Klos	1,038	1,712	1,426	1,672	2,346	1,706	1,908	21.7
Kolonjë	3,363	3,190	3,883	4,417	3,704	4,867	4,329	49.2
Konispol	3,359	5,216	5,142	3,917	3,536	4,667	4,040	45.9
Korçë	5,556	7,221	7,166	7,951	8,512	6,976	7,813	88.7
Krujë	3,118	4,493	3,687	5,353	5,095	4,410	4,953	56.2
Kuçovë	3,210	3,052	4,074	3,776	3,956	3,040	3,590	40.8
Kukës	1,613	1,918	1,695	1,561	2,587	3,348	2,499	28.4
Kurbini	1,232	1,306	1,543	1,337	1,332	848	1,172	13.3
Lezhë	4,375	4,281	5,012	6,098	10,204	4,361	6,888	78.2
Libohovë	2,096	3,087	3,210	2,966	2,488	2,150	2,535	28.8
Librazhd	1,896	2,418	2,917	3,345	3,442	3,371	3,386	38.4
Lushnjë	3,372	4,026	3,863	4,020	4,245	4,252	4,172	47.4
Malësi e Madhe	1,324	4,180	1,177	1,973	1,847	1,710	1,844	20.9
Maliq	1,323	1,967	2,138	2,922	2,124	2,130	2,392	27.2
Mallakastrë	3,915	7,245	7,902	11,564	5,101	3,655	6,773	76.9

	2015	2016	2016	2016	2016	2016	Mesatare 2018- 2020	Indeks Mesatarja 100
Mat	1,803	1,800	2,381	1,924	2,447	2,926	2,432	27.6
Memaliaj	1,292	1,590	1,335	1,020	995	1,212	1,075	12.2
Mirditë	1,222	2,178	1,594	2,424	2,567	1,985	2,325	26.4
Patos	4,454	4,791	4,277	9,257	5,685	7,571	7,504	85.2
Peqin	1,547	1,845	1,482	1,742	2,398	1,871	2,004	22.8
Përmet	3,242	3,841	2,883	3,699	3,623	3,959	3,760	42.7
